Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e tretë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. 01B/181, të datës 13.08.2021.

Librin për mësuesin mund ta shkarkoni në linkun: https://www.botimepegi.al/

ISBN: 978-9951-786-25-6
9 789951 786256

Laura Lipoveci Pruthi

LIBËR PËR MËSUESIN

Shkathtësi për jetë 3

BOTIME
pegi

Laura Lipoveci Pruthi

LIBËR PËR MËSUESIN

SHKATHTËSI PËR JETË 3

Për klasën e 3-të të arsimit fillor

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2021

BOTIME

Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Prof. Azem KYÇYKU, Vjollca BALIU,
Rita BERISHA
Korrektor: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Kopertina: Elidor Kruja
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN 978-9951-786-25-6

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, gusht 2021
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara
nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje,
shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht,
pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Të nderuar mësimdhënës,

Libri për mësuesin do t'ju shërbejë si udhëzues për t'ju ndihmuar në planifikimin dhe realizimin e situatave të të nxënit në klasë dhe jashtë saj. *Libri për mësuesin* përbën planifikimet për gjashtë tematika, që trajtohen në tekstin e nxënësve, të cilat rrjedhin nga rezultatet e të nxënit të fushës dhe rezultatet e të nxënit të lëndës, sipas shkallës së dytë të kurrikulës bërthamë. Ato bëjnë që organizimi i mësimit të përqendrohet drejt përvetësimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor dhe orientim për jetë dhe punë.

Temat e shtjelluara duke u bazuar në librin e nxënësit janë:

1. Materialet dhe përpunimi i tyre
2. Njohja nga rreziqet
3. Karriera ime
4. Planifikimi
5. Mjedisi dhe shëndeti
6. Mediet

Në këtë libër, përmes planifikimit të mirëfilltë është synuar që nxënësi/ja të arrijë shkathtësitë më të rëndësishme jetësore, si qëllim i lëndës "Shkathtësi për jetë": zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e shkathtësive për të zgjidhur probleme, shkathtësinë për marrjen e vendimeve, shkathtësitë e komunikimit, ballafaqimin me emocionet dhe stresin, aftësi për të prezantuar, puna në grupe, shkathtësitë sipërmarrëse. Përvojat mësimore në shkollë do të kontribuojnë për ambientimin e nxënësve me një formë më të sistemuar të të nxënit nëpërmjet lojës/mësimit/hulumtimit/projekteve të vogla/ punës praktike, duke filluar që ata të bëjnë dallimin mes lojës dhe obligimeve, pra planifikimi i procesit mësimor është bërë në mënyrë të integruar, duke mundësuar që marrëdhënia e fëmijëve me mjedisin natyror dhe me mjedisin e krijuar nga njeriu dhe lidhshmërinë me situatën jetësore, të kuptohet në mënyrë sa më të plotë.

Libri i mësuesit shtjellon strategjitë dhe teknikat e të pyeturit si element delikat gjatë orës mësimore, gjithashtu metoda, teknika, aktivitete të mësimdhënies që ju vijnë në ndihmë gjatë planifikimit dhe realizimit të situatave të të nxënit, konkretisht që janë përdorur gjatë planifikimit të njësive mësimore në këtë libër.

Libri për mësuesin përmban:

- *Hyrjen*
- *Sqarime për strategjitë dhe teknikat e të pyeturit /metodologjinë e mësimdhënies*
- *Integrimi me fushat kurrikulare*

- *Planin dhe programin e lëndës "Shkathtësi për jetë", klasa e tretë*
- *Planin vjetor*
- *Planet dymujore*
- *Planifikimet ditore për njësitë mësimore.*
- *Testet përmbledhëse*

Strategjitë dhe teknikat e të pyeturit

Mjeshtëria se si të përdoren strategjitë e të pyeturit në klasë ka një ndikim të rëndësishëm në procesin e të nxënit. Strategjitë e të pyeturit në orën e mësimit janë shumë delikate, sepse pikërisht pyetjet janë ato që i japin drejtimin e duhur orës mësimore. Pyetjet e bëra nga mësuesit kanë kuptim arsimor didaktik. Ato kanë për objekt nxënësin dhe synojnë arritje në aspektin mësimor dhe edukativ.

Strategjitë e të pyeturit janë një mjet i fuqishëm për të nxitur e përkrahur zhvillimin e mendimit kritik të nxënësit. Shqetësim i çdo mësuesi/eje është mënyra si nxënësit u përgjigjen pyetjeve të shtruara nga ai/ajo. Lënda Shkathtësi për jetë, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të parashtrimit të pyetjeve, ku fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe të punës; konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe i qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje në vazhdimësi dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se pyetjet duhen bërë me një gjuhë të thjeshtë dhe nxitëse. Këshillat e mëposhtme janë në sistemin e atyre që u tha deri më tani. Ato tregojnë procedurën e zakonshme të drejtimit të pyetjes dhe të marrjes së përgjigjes.

- Përdor teknikën: pyetje-pauzë-thirrje. Kjo do të thotë: shtroja pyetjen nxënësve, bëje një pauzë të shkurtër që ata të mendohen dhe, pastaj, thuaje emrin e nxënësit që doni t'i përgjigjet pyetjes. Një gjë e tillë nxit të gjithë të dëgjojnë dhe të përgatisin një përgjigje para se t'u bëhet thirrja, e cila mënjanon përgjigjen horazi.
- Të jesh sistematik, por i rastësishëm për çfarëdo që të kërkosh. Ata që do të përgjigjen nuk duhet thirrur sipas një radhe të caktuar. Në këtë mënyrë, nxënësit do të jenë më të përqendruar, pasi nuk e dinë radhën e të pyeturit. Atë e di vetëm mësuesi/ja, i cili/e cila është sistematik/e *në përdorimin e skemave të ndryshme të të pyeturit.*
- Pyetjet të jenë të niveleve të ndryshme, në fillim më të lehta e shkallë-shkallë më të vështirat. Më të vështirat për nxënësit e mirë dhe më të lehtat për nxënësit që përparojnë ngadalë. Kjo ndihmon në ruajtjen e niveleve të ndryshme motivuese dhe të ecurisë së mësimit.
- Mos reago kur nxënësi/ja jep përgjigje të gabuar. Mësuesi/ja nuk duhet të reagojë menjëherë për saktësinë e saj. Përvoja tregon se ka mësues që më shumë bëjnë pyetje, sesa marrin përgjigje. Aftësia dhe mjeshtëria e mësuesit qëndron në dëgjimin e dy-tri përgjigjeve dhe, pasi të bindet se nuk do t'i përgjigjen nxënës të tjerë dhe pasi e ka thjeshtësuar e ndryshuar atë, pastaj e jep përgjigjen.
- Pyet për riformulim të pyetjes, për të ndihmuar dëgjimin aktiv. Kjo bën që nxënësit të jenë të vëmendshëm në dëgjimin e përgjigjes së shokut të tyre, pasi mësuesi/ja mund të pyesë çdo çast: "... A ishte e saktë përgjigjja e…? A mund ta shprehesh me fjalë të tjera atë?"; kjo mënyrë e të pyeturit krijon gjithashtu një situatë më realiste në klasë, kontribuon në bashkëpunimin e nxënësve, duke aktivizuar edhe nxënësit e tjerë t'i përgjigjen pyetjes së shokut të tyre.

- Kalo në anën tjetër të çështjes, që të shohësh se nxënësit mund të mbrojnë përgjigjet e tyre. Pyetje të tilla si: "Pse janë këto rezultate?, Si e argumenton këtë?" etj., ndihmojnë që nxënësi/ja *të argumentojë çdo përgjigje. Kjo jo vetëm kur zgjidhja është e saktë, por edhe kur është e gabuar. Është e dobishme* të kontrolloni se si nxënësi/ja arrin te përgjigjja e dhënë (pavarësisht nëse është e drejtë apo e gabuar). Kjo ua bën të mundur që të ndriçoni të vërtetën *për mënyrën se si ka menduar nxënësi*/ja.
- Kur e drejton pyetjen, përpiqu të sigurohesh se është e qartë dhe e kuptueshme, duke shmangur dykuptimësitë. Nëse nxënësi/ja është në vështirësi, është gjithmonë e nevojshme të riformulosh pyetjen në mënyrë tjetër, të ndryshme nga e para. Më e rëndësishmja është të bësh pyetje, të tregosh se je i/e interesuar për përgjigjen, të mbash kontakt me sy me nxënësit dhe të sigurohesh se edhe nxënësit e tjerë kanë mirësjellje të dëgjojnë në heshtje.
- Kur nxit ose ndihmon një nxënës/e, kujtohu se qëllimi i saj është të ndihmojë të menduarit e nxënësve e jo të marrësh përgjigjen e saktë, që mund të jetë krejt e rastësishme, nga supozimi i ndihmuar nga udhëzimet e dhëna.

Teknikat e mësimdhënies që përdorë mësuesi/ja janë faktorë kryesorë që përcaktojnë një ndërveprim të suksesshëm. Kreativiteti i mësuesit/es në përzgjedhjen e teknikës adekuate për temën që trajton është unik. Disa nga teknikat që përdoren për të mësuarit përmes pyetjeve janë:

Teknika: LINK (Vughan & Esters 1986)

Në mësimin e lëndës *Shkathtësi për jetë*, nxënësit duhet të jenë pjesë e veprimit. Nëse ata qëndrojnë pasivë dhe vetëm dëgjojnë kur mësimdhënësi/ja shpjegon, të nxënit nuk është arritur ose është arritur shumë pak. Nxënësit kanë dëshirë të bëjnë pyetje, të bëjnë eksperimente dhe prova dhe entuziazmohen kur diçka ngacmon të menduarit e tyre. LINK që është akronim i fjalëve në anglisht, që në shqip do të thotë: Rendit, Kërko, Shëno dhe Mëso, (RKShM), është një teknikë e diskutimit të hapur që nxit nxënësit në diskutim të drejtpërdrejtë për njohuritë e tyre fillestare lidhur me temën. Për zbatimin e teknikës duhet të ndiqen këta hapa:

1. Vendosim për një koncept kryesor që lidhet me materialin që do të mësojmë, në mënyrë që të nxitë përgjigje nga nxënësit. Përgjigjet shënohen në tabelë, u kërkohet nxënësve që për tri minuta të renditin në fletore lidhjet për këtë përgjigje.
2. Nxiten nxënësit që të pyesin rreth termave të renditura në tabelë. Nxënësit mund të vënë në diskutim disa nga idetë e dhëna. Megjithatë, të gjitha pyetjet drejtohen për të ndjekur nxënësit, jo mësuesin. Qëllimi i përgjigjeve (të shpejta) është të bëjë që nxënësit përmes pyetjeve që parashtrojnë të bisedojnë me njëri-tjetrin dhe të arrijnë të zbulojnë temën.
3. Gjatë shqyrtimit dhe kërkimit, nxënësit bashkëveprojnë si për të shkëmbyer njohuritë, ashtu edhe për të zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi përgjigjen apo konceptin. Duhet t'u kujtojmë nxënësve të ndjekin rregullat, gjatë diskutimit, të respektojmë njëri-tjetrin gjatë shqyrtimit të konceptit.
4. Kur nxënësit të kenë kryer plotësisht shqyrtimet dhe komentet e tyre për temën, i fshijmë ato që kemi shkruar në tabelë. I udhëzon nxënësit të kthejnë mbrapsht fletët e tyre. Të vihet re çfarë kanë mësuar rreth fjalës treguese. Një mënyrë është që ata të shkruajnë një përkufizim për konceptin. Ajo çfarë ata shkruajnë, mund të bazohet si në përvojën e tyre, ashtu dhe në diskutimet në klasë gjatë hulumtimit. Tani nxënësit janë gati të lexojnë pjesën. Pas leximit, u kërkohet të shënojnë çfarë dinë që nga fillimi kur ndeshën në materialin e ri.

Teknika: Procedura e të ripyeturit

Sipas kësaj teknike, dy nxënës lexojnë tekstin së bashku, ndalojnë në fund të çdo paragrafi dhe pyesin njëri -tjetrin me radhë. Gjithashtu, mësimdhënësi u bënë pyetjeve nxënësve për idetë kryesore të paragrafit. Ato janë të tilla që përgjigja të mos jetë e gatshme në paragraf. Pasi të jetë përgjigjur në pyetjet e mësimdhënësit, i vjen radha nxënësit të pyes për paragrafin e njëjtë. Pasi të dy së bashku kanë hedhur dritë mbi të dhënat e paragrafit, kalojnë në paragrafin e dytë, me ç'rast bëjnë të njëjtën gjë.

Procedura e të ripyturit mund të përdoret njëherazi me të gjithë klasën. Të gjithë nxënësit lexojnë paragrafin në heshtje. Pastaj mbyllin librat dhe me radhë fillojnë të pyesin mësuesin rreth paragrafit të lexuar. Pastaj rolet ndërrohen. Kur drejtohen pyetje është e rëndësishme që të hartohen pyetje që nuk kanë përgjigje të gatshme faktike, por që ngacmojnë përdorimin e koncepteve dhe nënkuptimeve (Vacca & Vacca 1996).

Teknika: Harta e konceptit

Harta e koncepteve (Schwartz & Raphael) është një teknikë e përshtatshme për të mësuar koncepte të ndryshme në të gjitha lëndët. Zbatimi i metodës përfshin hapat që vijojnë:

1. Paraqitet një hartë e konceptit. Bëhen pyetje që të mund të marrim si përgjigje një përkufizim të plotë. P.sh.: Çfarë është kjo?, Si duket? Cilët janë disa shembuj të saj? Në fillim modelohet dhe më pas nxënësit duhet të mësohen si ta përdorin.
2. Paraqitet një term ose koncept i ri kryesor nga materiali që do ta mësojnë nxënësit. Vihen nxënësit të punojnë në dyshe, për të krijuar një hartë të konceptit (përkufizim për konceptin e ri). Udhëzohen të përdorin informacione nga materiali, ose duke përdorur informacione paraprake që kanë. Për shembull, në një orë mësimi nxënësit studiojnë temën "Materialet", atyre mund t'u jepet koncepti i drurit për të bërë hartën.
3. Kur nxënësit të kenë përfunduar hartat e tyre të koncepteve, u kërkohet të shkruajnë një përkufizim të plotë për konceptin.
4. U themi nxënësve të bëjnë studime të pavarura dhe të krijojnë harta të koncepteve për termat dhe konceptet e tjera kryesore nga tekstet ose libra të tjera që mund të përdoren si material shtesë dhe plotësues.

Mund të themi se çdo teknike ose metode mësimore u paraprijnë pyetjet, të cilat janë të pashmangshme në mësimdhënie; ne sqaruam disa prej tyre, megjithatë vlen të përmendim edhe teknikat si:

Mësimdhënia e ndërsjellë, Teknikat e diskutimit, Intervista me tre hapa, Intervista me tri faza, Pyetje për autorin, Teknika e përgjigjes së shumëfishtë etj.

Mësimdhënia me nxënësin në qendër

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lëndën "Shkathtësi për jetë" për klasën e tretë, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo lëndë, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin. Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit p.sh. grupe ekspertësh, simulimi i roleve etj.);
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar (ndihmon integrimin e modaliteteve dhe stileve të ndryshme të të nxënit si dhe të grupimit strategjik të nxënësve bazuar në nevojat e identifikuara);
- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e ne veçanti përmes kompjuterit;
- Ushtrimet me luajtje rolesh;
- Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.
- Teknikat dhe metodat e hulumtimit si: projekti (të mësuarit bazuar në projekte), zbulimi, zgjidhja e problemit, studimi i rastit, ekskursioni, vrojtimi etj.

Gjatë planifikimit të njësive mësimore janë përdorur gjithashtu teknika të ndryshme që zhvillojnë mendimin kritik te nxënësit, siç janë: Stuhi mendimesh, Trungu i mendimeve (Kllaster), Di/Dua të di/Mësova, Rrjeti i diskutimit, Ditari dypjesësh, Kubimi, Diagrami i Venit, Turi i galerisë, Imagjinata e drejtuar etj.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialit dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

Për të përfshirë gjithë nxënësit dhe për t'i bërë ata kureshtarë për temën që trajtohet, duhet të sigurohemi që të gjithë të kenë mundësi të jenë pjesëmarrës në diskutim. Mësimdhënësi/ja duhet të marrë hapa konkretë për të aktivizuar të gjithë nxënësit në mësimdhënie; ai/ja më së miri e bënë atë përmes këtyre veprimeve:

- *mësimdhënia çdoherë i përshtatet nxënies së suksesshme të nxënësve;*
- *krijohet një mjedis i këndshëm e miqësor në klasë, me qëllim që të nxitet interesimi dhe motivimi i nxënësve për të nxënë;*
- *mësuesi/ja gjatë punës/aktivizimit të nxënësve, mbikëqyr, ndihmon dhe lehtëson të nxënit e nxënësve;*
- *nxënësi/ja është pjesëmarrës aktiv dhe i angazhuar/i përfshirë në aktivitetet, që nxisin nxënien dhe interesimin e nxënësve;*
- *temat e nxënies janë relevante dhe interesante për nxënësit;*
- *nxënësit inkurajohen të bëhen përgjegjës, të pavarur e refektivë dhe të vazhdojnë nxënien gjatë gjithë jetës së tyre;*
- *mësuesi/ja ndjek ndryshimet individuale të nxënësve përmes vrojtimit dhe bashkëveprimit;*
- *aktivitetet mësimore përshtaten në bazë të nivelit zhvillimor të nxënësve;*
- *mësimdhënia dhe vlerësimi planifikohen, duke pasur parasysh zhvillimin individual dhe stilet e nxënies së nxënësit;*
- *ofrohen llojllojshmëri të mundësive të nxënies dhe të metodave të vlerësimit, për të përkrahur stilet e ndryshme të nxënies së nxënësit;*
- *përdoren burime të ndryshme të nxënit që nxitin pjesëmarrjen, vëzhgimin, pavarësinë, kërkimin dhe kureshtjen e nxënësve;*
- *vrojtimet dhe vlerësimet e nxënësve përdoren për të planifikuar mësimdhënien e mëtejshme;*
- *njihen dhe trajtohen në mënyrën e duhur nxënësit e talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.*

Integrimi me fushat kurrikulare

Gjatë planifikimit të njësive mësimore, është bërë integrimi me fushat tjera duke kontribuuar në kuptimin e koncepteve në mënyrë të ndërsjellët dhe duke bërë lidhshmërinë e fakteve me jetën e përditshme.

- Gjuhë dhe komunikim

Komunikimi (me gojë dhe me shkrim) bëhet përmes vrojtimit, diskutimit, modelimit, vizatimit, reflektimi me shkrim, interpretimi i ilustrimeve, prezantimi i projekteve, paraqitja e të dhënave të hulumtimeve.

- Artet

Përmes aktiviteteve të ndryshme ndërlidhet fusha e artit si dhënia e koncepteve përmes vizatimit, modelimit, muzikës etj.

- Matematikë

Zhvillimin e aftësive logjike gjatë hulumtimeve duke përdorur modele, krahasimin e numrave (madhësisë, gjatësisë, lartësisë, formës etj.), përdorimin e operacioneve themelore matematikore dhe shprehjen e madhësive përmes vlerave gjatë punës praktike.

- Shoqëria dhe mjedisi

Përshkruan mjedisin natyror-shoqëror që e rrethon dhe shpreh gatishmërinë për të punuar në grup dhe për të krijuar raporte të mira në shoqëri (me shokë, shoqe, familje, komunitet) dhe ruajtje të mjedisit.

- Shkencat e natyrës

Lidhshmëria me temat e përbashkëta që trajtohen për mjediset natyrore, materialet dhe tema tjera të përbashkëta bëjnë që kontributi në arritjen e rezultateve të pritshme është i ndërsjellët.

- Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Përmes edukimit shëndetësor fiton shprehi, qëndrime e sjellje pozitive për mbrojtjen e shëndetit personal, për një mirëqenie më të mirë, duke dalluar të mirat dhe rreziqet nga mjedisi i saj/tij.

Gjithashtu, janë të planifikuara aktivitetet jashtëkurrikulare përmes vizitave të ndryshme, të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve të kompetencave.

Programi i lëndës "Shkathtësi për jetë", klasa e tretë

Hyrje

Lënda *Shkathtësi për jetë* në klasën e tretë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive drejt përvetësimit të njohurive të reja, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijesim dhe vetëbesim për ushtrimin e punës praktike, përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin lidhur me ekonominë familjare, me mjedisin jetësor dhe orientim për jetë dhe punë.

Lënda *Shkathtësi për jetë* ndihmon që nxënësit të përgatiten për punë dhe jetë në shekullin XXI, duke e kaluar theksin nga mësimdhënia e njohurive të nxënësve pasiv në atë të zhvillimit të kompetencave, shkathtësive dhe qëndrimeve përmes mësimnxënies aktive. Në kuadër të lëndës *Shkathtësi për jetë* do të zhvillohen module, të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 2 si: Punëdore, Zhvillimi personal, shkathtësi për jetë, Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Ekonomia familjare, Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe Puna dhe edukimi për ndërmarrësi. Të gjitha këto koncepte zhvillohen në ndërlidhje të rezultateve të fushës dhe të lëndës për të arritur qëllimin kryesor të fushës Jeta dhe Puna. Kjo lëndë përfshin përpjekjet sistematike për të ndikuar në procesin e zhvillimit të nxënësve të cilët përmes procesit të të mësuarit përdorin materiale të ndryshme, mjetet e punës të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive për jetë dhe punë. Lënda ndikon te fëmijët në zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin e aftësive për të zgjidhur probleme, nxitjen e kreativitetit, aftësinë prezantuese, rritjen e vetëbesimit dhe punën ekipore.

Qëllimi

Qëllimi i lëndës *Shkathtësi për jetë* për klasën e tretë është që nxënësi/ja të njihet me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe punë, të njihet me materialet e ndryshme dhe përdorimin e tyre, njohjen nga rreziqet, zhvillimin e karrierës, planifikimin e ekonomisë familjare, mjedisin dhe shëndetin, si dhe mediet. Nëpërmjet lëndës *Shkathtësi për jetë* rritet niveli i njohurive dhe shkathtësive për jetën e përditshme, duke përfshirë konceptet bazë të fushës Jeta dhe puna.

Përmes lëndës *Shkathtësi për jetë* për klasën e tretë, mësimi në shkollë bëhet më atraktiv dhe më i kënaqshëm përmes aktiviteteve të ndryshme praktike në të cilat nxënësit nxiten që të marrin pjesë. Synimi kryesor në klasën e tretë është që nxënësit të identifikojnë interesimet e tyre për ndonjë veprimtari apo shkathtësi, siç janë: përpunimi i materialeve ricikluese, moderimi, krijimi i gazetës shkollore apo asaj në klasë, qepja, prerja, matja, organizime të ndryshme (humanitare, argëtuese) etj.

Shkathtësitë më të rëndësishme jetësore që nxënësi/ja duhet t'i arrijë nëpërmjet lëndës *Shkathtësi për jetë* janë:

- *Të menduarit kreativ dhe kritik*
- *Shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve*
- *Shkathtësitë e marrjes së vendimeve*
- *Shkathtësitë e komunikimit*
- *Ballafaqimi me emocionet dhe stresin*
- *Aftësitë për të prezantuar*

- *Puna në grup*
- *Shkathtësitë sipërmarrëse*

Temat dhe rezultatet dhe të nxënit

Nxënësit në klasën e tretë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe puna, të shkallës së parë të kurrikulës (SHk 1) në Kurrikulën bërthamë për arsimin fillor:

<table>
<tr><td>Koncepti</td><td colspan="2">RNF, TEMA dhe RNL</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Zhvillimi i bazuar në aktivitete praktike manuale (Punëdore)</td><td colspan="2">RNF
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
1.1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup.
1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë
Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.</td></tr>
<tr><td>Tema</td><td>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</td></tr>
<tr><td>1. Materialet dhe përpunimi i tyre</td><td>Nxënësi/ja:
-përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit;
-klasifikon llojet e letrës dhe të kartoni;
-identifikon vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit;
-modelon objekte nga letra dhe kartoni;
-dallon materialet si: leshi, pambuku dhe materialet sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore;
-përshkruan procesin e qethjes, larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit;
-përshkruan procesin e kultivimit, tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.</td></tr>
<tr><td>Zhvillimi personal, shkathtësi për jetë</td><td colspan="2">RNF
3. Përdorimi i teknologjisë për jetë dhe për punën e përditshme
3.1. Përdorë vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë
6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.</td></tr>
<tr><td></td><td>2. Njohja nga rreziqet</td><td>Nxënësi/ja:
-përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike;
-zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike: prizat, çelësat, poçat, përçuesit etj.;
-identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa preventive për parandalimin e tij;</td></tr>
</table>

		-identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtyre rreziqeve; -njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit, telefonit etj., dhe vetëdijesohet për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektronike; -identifikon disa nga substancat kryesore kimike dhe mjetet shpërthyese që mund t'i hasë nxënësi në shtëpi, shkollë, terren të hapur etj.
Këshillimi dhe orientimi në karrierë	**RNF** **4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme** 4.1. Përdorë kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike. 7**. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme** 7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.	
	3. Karriera ime	Nxënësi/ja: -prezanton para klasës përmes TIK-ut imazhe që ndërlidhen me punën dhe profesionet; -identifikon përmes objekteve/institucioneve llojet e vendeve të punës; -paraqet shkathtësi dhe dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm; -krijon një projekt të vogël me materiale të ndryshme, që lidhen me profesione të caktuara.
Ekonomia familjare	**RNF** **1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet** 1.2. Ndërmerr aktivitete praktike, bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim. **5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit** 5.1. Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative–buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.	
	4. Planifikimi	Nxënësi/ja: -kontribuon në ekonominë familjare; -organizon aktivitete argëtuese, humanitare, ruajtjen e mjedisit etj.; -planifikon dhe punon një produkt prej materialeve ricikluese.

Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	**RNF** **6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë** 6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis. **9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit** 9.1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit. 9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut**.**	
	5. Mjedisi dhe shëndeti	Nxënësi/ja: -identifikon repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë: si ato për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor; -përpilon orarin e lojës apo të argëtimit në kohën kur nuk pengon në mjedisin jetësor; -përshkruan dëmet që shkaktohen në mjedis nga djegia e mbeturinave, tymtarët e fabrikave, lirimi i gazrave nga makinat etj.; -prezanton situatat e ndryshme se si bëhet mbrojtja e mjedisit; -përshkruan prezencën e deponive, grumbullimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre.
Puna dhe edukimi për ndërmarrësi	**RNF** **2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë** 2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup. **4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme** 4.1. Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare. 4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.	
	Mediet	Nxënësi/ja: -prezanton para klasës disa lloje mediesh që shikon në shtëpi për moshën e tij; -moderon aktivitete brenda klasës para prindërve për festa të ndryshme; -organizon aktivitete të lira në kuadër të grupeve kulturore brenda klasës; -prezanton përmes TIK-ut aktivitetet e grupit të tij për një periudhë të caktuar kohore; -krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe me imazhe interesante.

Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lëndën *Shkathtësi për jetë* për klasën e tretë mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo lëndë, por edhe për shkak të specifikave që mbart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Ushtrimet me luajtje rolesh;
- Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialit dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

Në kuadër të lëndës *Shkathtësi për jetë*, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, dhe që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Lënda *Shkathtësi për jetë* duhet realizuar në atë mënyrë që t'u mundësojmë nxënësve përmirësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KKK. Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t'i reflektojnë.

Çështjet ndërkurrikulare

Në kuadër të lëndës *Shkathtësi për Jetë*, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj duhet të jetë edhe realizimi i çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK.

Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medies (përdorimi i medies për ta kuptuar botën përreth);
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;

- Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë;
- Puna vullnetare.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe mjaft të rëndësishme të mësimdhënies në shkollën bashkëkohore. Nxënësit nxënë mjaft gjatë viteve të shkollimit. Sidoqoftë, jo gjithçka që ata nxënë mund të matet me anë të testeve, edhe për faktin se, për nxënësit e nivelit fillor, përdorimi i teknikave të ndryshme mundëson vlerësim sa më realist bazuar në karakteristikat e ndryshme të nxënësve.

Lënda *Shkathtësi për jetë*, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ku fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe të punës; konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe i qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje në vazhdimësi dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme. Për shkak të specifikave që ka kjo lëndë do të ishte e vlefshme që, përveç vlerësimit numerik, në masë të madhe të aplikohej vlerësimi përshkrues pasi puna në grup, projektet, aftësitë psikomotore, aftësia e të folurit etj., nuk mund të maten me anë të testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato, përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për lëndën Shkathtësi për jetë dhe punë, e cila mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Ekzistojnë disa teknika dhe instrumente që ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësit, të cilat përdoren për vlerësim. Ja disa prej tyre:

Buletini i pjesëmarrjes, përshkruhet si një teknikë vrojtimi që mund të përdoret për të vrojtuar, në grupe të vogla ose gjatë diskutimit. Buletini tregon se cili jep ndihmesë, sa shpesh bashkëpunon, sa të vlefshme janë ndihmesat etj.

Lista e kontrollit, është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, njohuri, për të cilat nxënësi/ja do të vëzhgohet. Qëllimi kryesor i listës së kontrollit është të regjistrojë një vlerësim të vazhdueshëm për përparimin e nxënësit, duke dëshmuar se si i përmbush ai detyrat ose objektivat e llojeve të ndryshme. Krahas listës me elementet që do të vrojtohen, jepet edhe një shkallë vlerësuese.

Dosja e nxënësit, është një mjet që mund të përdoret për të treguar modele të punëve të nxënësve, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve. Dosja mund të përmbajë, për shembull, vizatime, një projekt, një krijim, plane etj.

Dosja ka vlera për këto arsye:

- Është një mjet që u jep informacion mësuesit, prindërve dhe nxënësve.
- Nxënësit i jep një pasqyrë tërësore të punës së tij.
- Duke e përgatitur vetë dosjen, nxënësi/ja luan rol aktiv në procesin e mësimit dhe të vlerësimit.

Materialet mësimore dhe burimet për mësimdhënie dhe për nxënie

Për realizimin me sukses të kompetencave në lëndën *Shkathtësi për jetë* është e rëndësishme që të përdoren burime të ndryshme mësimore për t'i motivuar nxënësit dhe për të stimuluar progresin e tyre në mënyrë

që të përvetësojnë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për jetë dhe për punë në jetën e përditshme. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të nxënies, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizim më të suksesshëm të lëndës Shkathtësi për jetë duhet të përdoret një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe materiale përkatëse pune. Mësimdhënësit, nxënësit dhe bartësit e tjerë të arsimit, po ashtu mund të angazhohen në hartimin e burimeve të përshtatura mësimore, p.sh., rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

Mësimdhënësit mund të përgatisin dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e materialeve të ndryshme, përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

PLANI VJETOR 2020-2021

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe Puna Klasa: III Shkalla: II

Lëndët e fushës kurri-kulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)	
	Shtator Tetor 9 orë	Nëntor Dhjetor 8 orë	Janar Shkurt Mars 11 orë	Prill Maj Qershor 10 orë	
Lënda: Shkathtësi për jetë	Materialet dhe përpunimi i tyre (7 orë) Njohja nga rreziqet (2 orë)	Njohja nga rreziqet (6 orë) Karriera ime (2 orë)	Karriera ime (2 orë) Planifikimi (5 orë) Mjedisi dhe shëndeti (3 orë)	Mjedisi dhe shëndeti (3 orë) Mediet (7 orë)	Komunikues efektiv I. 1, 3, 4, 5, 8 Mendimi kreativ II. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Nxënës i suksesshëm III. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 Komunikues produktiv IV. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Individ i shëndoshë V. 1, 2, 7, 8 Qytetar i përgjegjshëm VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8

PLANI DYMUJOR SHTATOR-TETOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë**
Klasa: E tretë **Shkalla: II**

Tema mësimore: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Mendimtar kreativ:

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në koh**ë e hapësirë dhe bashkëveprimit**) të tyre.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.7 lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë-adekuat.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.1. Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup.

1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.

2.1 Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.

3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësimdhënësit.

9.1 Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.

Tema mësimore: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

II.4 Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.

Nxënës i suksesshëm:

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.7 Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

VI.8 Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes **shtjellimit të temës/ve:**

3.1. Përdorë vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.

6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Materialetdhe përpunimi tyre (7 orë) **Njohja nga rreziqet (2 orë)**	-Përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit. -Klasifikon llojet e letrës dhe të kartonit. -Identifikon vetitë e ndryshme të letrës dhe të kartonit. -Modelon objekte nga letra dhe kartoni. -Dallon materialet si: leshi, pambuku dhe materialet sintetike si zëvendësim i materialeve natyrore. -Përshkruan procesin e qethjes, larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit. -Përshkruan procesin e kultivimit, tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.	1.1 Përpunimi i letrës dhe kartonit 1.2 Llojet e letrës dhe të kartonit 1.3 Veprimtari: modelon objekte me letër dhe karton 1.4 Llojet e tekstileve: leshi, pambuku, sintetike 1.5 Procesi i qethjes, larjes, përpunimit dhe krehjes së leshit 1.6 Procesi i tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut 1.7 Veprimtari: riciklime me materiale leshi dhe pambuku	9 orë	Bashkëbiseduese Punë grupore Punë në çift Punë individuale Demonstruese Audiovizuale Vizualizim Puna me projekte Mësimi përmes lojës Stuhi mendimesh Punë e pavarur Kubimi Diagrami i Venit Pema e mendimeve Ditari dypjesësh DRTA Rrjeti i diskutimit Di – Dua të di – Mësova Pyetje binare Diskutim për njohuritë paraprake	Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë Semafori Dy yje një dëshirë Vetëvlerësim	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Matematikë Çështjet **ndërkurrikulare** -Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti shkollor “Shkathtësi për jetë 3” Broshura, Atlase, Enciklopedi, Softuerë arsimorë **Interneti:** https://www.pinterest.com/pin/516084438552617073/ https://www.pinterest.com/pin/773493304739764734/

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	-Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike. -Zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike: prizat, çelësat, poçat, përçuesit etj.	2.1 Rreziku nga pajisjet elektrike 2.2 Rregullat e parandalimit të rreziqeve nga pajisjet elektrike					

PLANI DYMUJOR NËNTOR-DHJETOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë**
Klasa: E tretë **Shkalla: II**

Tema mësimore: Njohja nga rreziqet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

II.4 Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë, mund të përdoret në situata të ngjashme.

Nxënës i suksesshëm:

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.7 Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

VI.8 Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhet manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

3.1. Përdorë vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.

6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

Tema mësimore: Karriera ime

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

III.8 Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Individ i shëndoshë:

V.7 Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

V. 8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.4 Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

4.1. Përdorë kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.

4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.

7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Njohja nga rreziqet (7 orë) **Karriera ime (1 orë)**	-Identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa preventive për parandalimin e tij. -Identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtyre rreziqeve. -Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit, telefonit etj., dhe vetëdijesohet për përdorimin e drejtë të pajisjeve elektronike.	2.3 Rreziqet dhe mbrojtja nga zjarri 2.4 Rreziqet nga lartësitë: ballkoni, puseta, shkallët 2.5 Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve 2.6 Substancat kimike dhe kujdesi ndaj tyre 2.7 Veprimtari: Vizitë në repartin zjarrfikës - Aktivitet rreth njësive të mësuara (fletë pune) - Vlerësim përmbledhës	8 orë	Bashkëbiseduese Punë grupore Punë në çift Punë individuale Demonstruese Audiovizuale Vizualizim Puna me projekte Mësimi përmes lojës Stuhi mendimesh Punë e pavarur Kllasteri Diskutim për njohuritë paraprake Mësim jashtë klase Pema e mendimeve Ditari dypjesësh DRTA Rrjeti i diskutimit Di – Dua të di – Mësova Pyetje binare	Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë Vetëvlerësim Test përmbledhës	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi, Matematikë Çështjet **ndërkurrikulare** -Globalizimi dhe ndërvarësia -Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti shkollore “Shkathtësi për jetë 3” Broshura Atlase Enciklopedi Softuerë arsimorë **Interneti:** https://www.pinterest.com/pin/516084438552617073/ https://www.pinterest.com/pin/773493304739764734/

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	-Identifikon disa nga substancat kryesore kimike dhe mjetet shpërthyese që mund t'i hasë nxënësi në shtëpi, shkollë, terren të hapur etj. -Prezanton para klasës përmes TIK-ut imazhe që ndërlidhen me punën dhe profesionet.	3.1 Profesionet që njoh					

PLANI DYMUJOR JANAR-SHKURT-MARS

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë
Klasa: E tretë Shkalla: II

Tema mësimore: Karriera ime

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete, që kërkohet prej tij/saj.

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

III.8 Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Individ i shëndoshë:

V.7 Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.

V. 8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.4 Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

4.1. Përdorë kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.

4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.

7.1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësive, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

Tema mësimore: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Mendimtar kreativ:

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.3 Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.6 Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelore/grafike apo në një formë tjetër.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.4 Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

VI.6 Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

VI.7 Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet-mënyra e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.2. Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdore, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.

2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.

5.1. Drejtpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative–buxhetore, duke zhvilluar shpirtin e ndërmarrësit.

Tema mësimore: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Mendimtar kreativ:

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore -historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III. 2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.

III.6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

III. 9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.1 **Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara**, duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.

IV.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.5 Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.1 Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.

V.2 Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt**ë**, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

VI.6 Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

6.1. Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

9.1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.

9.2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Karriera ime (3 orë) **Planifikimi (5 orë)** **Mjedisi dhe shëndeti (3 orë)**	-Identifikon përmes objekteve/ institucioneve llojet e vendeve të punës. -Paraqet shkathtësi dhe dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm. -Krijon një projekt të vogël me materiale të ndryshme që lidhen me profesione të caktuara. -Kontribuon në ekonominë familjare.	3.2 Vendi i punës sipas profesionit 3.3 Profesioni që më pëlqen 3.4 Projekt: Unë do të bëhem… 4.1 Ekonomia familjare 4.2 Organizimi i një feste 4.3 Projekt: Punime me materiale të ricikluesshme Aktivitet rreth njësive të mësuara (fletë pune) Test përmbledhës 5.1 Zhurmat në mjedis	11 orë	Bashkëbiseduese Punë grupore Punë në çift Punë individuale Demonstruese Audiovizuale Vizualizim Puna me projekte Të mësuarit përmes lojës Stuhi mendimesh Punë e pavarur Kllasteri Diskutim për njohuritë paraprake Pema e mendimeve Ditari dypjesësh DRTA	Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë Vetëvlerësim Test përmbledhës	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Matematikë Çështjet **ndërkurrikulare** -Globalizimi dhe ndërvarësia -Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti shkollore "Shkathtësi për jetë 3" Broshura Atlase Enciklopedi Softuerë arsimorë **Interneti:** https://ëëë.simplykinder.com/free-recycling-sort/, https://www.pinterest.com/pin/773493304739764734/ https://www.pinterest.com/pin/773493304739596376/

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	-Organizon aktivitete argëtuese, humanitare, ruajtjen e mjedisit etj. -Planifikon dhe punon një produkt prej materialeve ricikluese. -Identifikon repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë: si ato për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor. -Përpilon orarin e lojës apo të argëtimit në kohën kur nuk pengon në mjedisin jetësor.	5.2 Argëtohem në kohën e lirë 5.3 Mbrojtja e mjedisit nga tymi		Rrjeti i diskutimit Di – Dua të di – mësova Pyetje binare			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	-Përshkruan dëmet që shkaktohen në mjedis nga djegia e mbeturinave, tymtarët e fabrikave, lirimi i gazrave nga makinat etj.						

PLANI DYMUJOR PRILL-MAJ-QERSHOR

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna **Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë**
Klasa: E tretë **Shkalla: II**

Tema mësimore: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Mendimtar kreativ:

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse.

II.3 Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.

III.6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

IV.1 Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara, duke i gjetur të përbashkëtat me profesionet e dëshiruara.

IV.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera, **që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.**

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

IV.5 Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë-laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.

IV.8 Paraqet në formë tabelore, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

Individ i shëndoshë:

V.1 Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.

V.2 Merr pjesë në aktivitete fizike-lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejtë, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.

V. 8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.5 Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërës rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.

VI.6 Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

6.1 Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

9.1 Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.

9.2 Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

Tema mësimore: Media

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

Komunikues efektiv:

I.1 lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.

I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.

I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.

I.8 Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Mendimtar kreativ:

II.2 Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna

Nxënës i suksesshëm:

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.

III.6 Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

III.9 Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

Kontribuues produktiv:

VI.2 Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.

IV.3 Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupojnë atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.

IV.4 Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.

VI.3 Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh. besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti-mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret, përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.

VI.4 Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

VI.6 Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

2.1. Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.

4.1. Përdorë kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.

4.2. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Mjedisi dhe shëndeti (3 orë) **Mediet (7 orë)**	-Prezanton situatat e ndryshme se si bëhet mbrojtja e mjedisit. -Përshkruan prezencën e deponive, grumbullimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre. -Prezanton para klasës disa lloje mediesh që shikon në shtëpi për moshën e tij. -Moderon aktivitete brenda klasës para prindërve për festa të ndryshme.	5.4 Kontribuoj në mbrojtjen e mjedisit 5.5 Vendgrumbullimi i mbeturinave dhe riciklimi i tyre 5.6 Veprimtari: Masat për mbrojtjen e mjedisit 6.1 Llojet e medieve 6.2 Drejtoj aktivitetin për festën e shkollës 6.3 Grupi letrar organizon "Orë letrare" 6.4Veprimtari: Si të përgatitim një fletëpalosje	10 orë	Bashkëbiseduese Punë grupore Punë në çift Punë individuale Demonstruese Audiovizuale Puna me projekte Vizualizim Punë hulumtuese Të mësuarit përmes lojës, teatrit Stuhi mendimesh Punë e pavarur Pema e mendimeve Ditari dypjesësh DRTA	Buletini i pjesëmarrjes Lista e kontrollit Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë Vetëvlerësim Test përmbledhës	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Matematikë Çështjet **ndërkurrikulare** -Edukimi për media -Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti shkollore "Shkathtësi për jetë 3" Broshura, Atlase, Enciklopedi, Softuerë arsimorë **Interneti:** https://www.simplykinder.com/free-recycling-sort/, https://www.youtube.com/watch?v=f6-BXv8Ryoc https://www.pinterest.com/pin/773493304739596376/

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	-Organizon aktivitete të lira në kuadër të grupeve kulturore brenda klasës. -Prezanton përmes TIK-ut aktivitetet e grupit të tij për një periudhë të caktuar kohore. -Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe me imazhe interesante.	6.5 Projekt: Si të përgatitim një lajm Aktivitete rreth njësive të mësuara (fletë pune) Test përmbledhës		Rrjeti i diskutimit Pyetje binare Diskutim për njohuritë paraprake			

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës**: Përshkruan procesin e prodhimit të letrës dhe të kartonit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,6,8; III.1,2; IV.7,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përpunimi i letrës dhe kartonit			
Fjalët kyçe: letër, karton i sheshtë, karton i valëzuar, prodhim, celulozë, papirus etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon njohuritë paraprake për letrën/kartonin; - analizon informacionin me ndalesa; - përgjigjet saktë kërkesave duke u bazuar në informacionet e reja. **Kriteret e suksesit:** - Thuaj çfarë di për letrën. - Analizo prodhimin e letrës sipas skemës. - Plotëso saktë organizuesin grafik.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fletorja, letër, karton i sheshtë dhe karton i valëzuar, ilustrime **të prodhimit të letrës dhe kartonit etj.**			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi **për zhvillim të qëndrueshëm**.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Diskutim për njohuritë paraprake Paraqiten para nxënësve letra/kartonë të ndryshme dhe u kërkohet të thonë çfarë dinë për to. Nxënësit kanë kohë pesë minuta të listojnë në grup çfarëdo që u vjen në mendje për letrën dhe kartonin. Njëri anëtar i grupit paraqet para klasës njohuritë paraprake për letrën dhe kartonin. Pasi secili grup referon, hapen librat në faqen 6. Hapi 2 Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin e parë dhe të thonë sa përshtatet me shkrimet e tyre të bëra paraprakisht. Në këtë mënyrë, arrijmë në përfundim se ca letra përdoren për të shkruar (letër shkrimi) e ca të tjera për të ambalazhuar gjërat. Mësuesja/si shtron pyetjen: *Çfarë mendoni, si prodhohet letra?* Pas diskutimit në klasë, lexohet dhe analizohet paragrafi i radhës. *Çfarë kuptuat për prodhimin e letrës?* *Nga se prodhohet ajo?* *Ku gjendet celuloza?*			

Sqaro prodhimin e letrës nga rrobat e vjetra. Cila është arsyeja e prodhimit të letrës nga rrobat?
Cili është mënyra më e mirë për të prodhuar letrën?
Hapi 3
U kërkohet nxënësve, që në mënyrë të pavarur, të plotësojnë tabelën në libër, duke iu përgjigjur pyetjes.
Detyrë

Cilat sende, që përdoren më shpesh në jetën e përditshme, janë prodhuar me letër/karton?

Objekti/sendi	Gota	Shishe	Pjata	Kuti	Fletore	Libër	Qese
Letër/Karton	L/K	K			L		

Në përfundim, nxënësit paraqesin punimin e tyre dhe japin shembuj shtesë, duke iu referuar kërkesës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes gjatë orës mësimore.
Diskutimi rreth pyetjeve të shtruara.
Saktësia e punimit të detyrës.

Detyrë shtëpie

Hulumto në shtëpi për mostër letrash apo kartoni dhe silli në klasë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Klasifikon llojet e letrës dhe të kartonit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,6,8; III.1,2; IV.7,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e letrës dhe të kartonit			
Fjalët kyçe: veti të letrës/kartonit, ambalazh.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton për të gjeturat për llojet e letrës dhe kartonit; - sqaron vetitë e letrës para klasës, **përmes bashkëbisedimit**; - gjen të përbashkëtat dhe t**ë** veçantat e letrës dhe kartonit. **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti **i nxënësit**, fletorja, letër, karton i sheshtë dhe karton i valëzuar, ilustrime të prodhimit të letrës dhe kartonit etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi **për zhvillim të qëndrueshëm**.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Secili grup paraqet gjërat (llojet e letrës apo kartonit) qe ka sjellë në klasë. Hapet diskutimi fillimisht brenda grupeve, për të vazhduar pastaj në diskutim frontal.

- Çfarë keni sjellë?
- Si ngjasojnë? Nga se ndryshojnë?
- Si janë të ndërtuara?
- Me çfarë materiali janë punuar?
- Cili material, letra apo kartoni, është më i përshtatshëm për të punuar me të? Pse?

Në këtë mënyrë, arrijmë te tema që do të trajtohet.

Hapi 2

Njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të njësisë mësimore. Në bashkëpunim, bëhet analiza e figurave, duke ndarë letrat që përdoren për të shkruar dhe ato për të ambalazhuar.

- Vështro figurat dhe veço cilat janë letra për shkrim dhe cilat për ambalazhim. Shkruaj funksionin që kryejnë. P.sh.:

Në këtë mënyrë, arrijmë te vetitë e letrës. Në vazhdim, duke u bazuar në vetitë e letrës dhe të dhënat për kartonin e sheshtë dhe atë të valëzuar, nxënësit bëjnë krahasimin e materialit, praktikisht duke prekur materialin (letrën, kartonin e sheshtë dhe atë të valëzuar), që kanë sjellë në klasë.

Hapi 3

Në pjesën e fundit të orës, u kërkohet nxënësve të diskutojnë dhe të plotësojnë tabelën në librin e nxënësit.

- Çfarë mësove për vetitë e letrës?
- Cilat objekte duhet të ambalazhohet me karton? Pse?
- Sqaro përdorimin e kartonit të sheshtë dhe kartonit të valëzuar.
- Në tabelën e mëposhtme, gjej të përbashkëtat dhe të veçantat e letrës dhe të kartonit.

Letra	Të përbashkëta	Kartoni

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen *përgjigjet në pyetjet gjatë analizës së përmbajtjes.*

Plotësimi i saktë i tabelës, duke gjetur t*ë* përbashkëtat dhe t*ë* ve*çantat e letrës dhe kartonit.*

Detyrë shtëpie

Sjell në klasë ambalazhe letre ose kartoni.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Modelon objekte nga letra dhe kartoni.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5,8; III.4,9; IV.3,4; V.8; VI. 2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1; 3.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Modelime me letër dhe karton			
Fjalët kyçe: letër, karton, ambalazh, krijim, objekt.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - organizon punën në grup për veprimtari praktike; - krijon objekte të ndryshme me letër/karton; - shpjegon punimin në turin e galerisë. **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësit, ilustrime, figura, ambalazhe kartoni, letër me ngjyrë, gërshërë, vizore, lapsi, ngjyrat, ngjitëse letre etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Matematikë. Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Fillimisht organizohen nxënësit në klasifikimin e materialeve që kanë sjellë nga shtëpia dhe materialet ekzistuese në klasë (letër me ngjyrë, karton të sheshtë/valëzuar, ambalazhe të ndryshme etj.). Ndahen nxënësit në pesë grupe dhe duke u bazuar në shembujt në librin të nxënësit dhe në fletoren e punës f. 6 dhe 7, secili grup përcaktohet për punimin që do bëjë.

Hapi 2

Pasi të jetë përcaktuar se çfarë do të punojnë, nxënësit bashkërisht ndajnë obligimet për të realizuar detyrën.

Gr. 1



Gr. 2

Gr. 3

Gr. 4

Gr. 5



(Mësuesi/ja mund të hulumtojë në internet gjatë orës mësimore për modele të ndryshme, që të stimulojë kreativitetin e nxënësve, gjatë punës praktike.)

Hapi 3
Turi i galerisë
Pasi nxënësit të kenë përfunduar punimet, bëhet ekspozita në klasë. Nxënësit vizitojnë punimet dhe japin sqarime si kanë punuar.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet *përdorimi i drejtë i mjeteve të punës (gërshërë, ngjitës, vizore etj.)*.
Vlerësim i ndërsjellët për punimet.

Detyrë shtëpie

Hulumto në internet modele të punimeve me dorë me letër/karton dhe tregoi idetë në klasë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon materialet si leshi, pambuku dhe materialet sintetike, si zëvendësim i materialeve natyrore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,6,8; III.1,2; IV.7,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1; 3.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e tekstileve: leshi, pambuku, sintetike			
Fjalët kyçe: fibër tekstile natyrore/kimike, pambuk, mëndafsh, lesh.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon llojet e veshjeve sipas materialit; - analizon tekstin me ndalesa; - plotëson saktë organizuesin grafik për llojet e fibrave. **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, burime nga interneti, materiale prej leshi/pambuku/sintetike, ilustrime etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Edukatë muzikore, Edukatë fizike, Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra.
Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1
Aktivitet
Ulen nxënësit në rreth dhe mësuesi/ja u sqaron rregullat e lojës:
- Ngrihu në këmbë dhe sillu rreth grupit kur dëgjon fjalinë që përshtatet me veshjen tënde.
- Gjej karrigen për t'u ulur kur ndalon muzika.

Nxënësi/ja që mbetet pa ulëse, humbet lojën.
Fillon loja dhe mësuesi/ja thotë:
- Sillet rreth grupit me ritmin e muzikës, nxënësi/ja që ka të veshur bluzë pambuku/leshi etj.

Në këtë mënyrë, arrijmë te tema që do të trajtohet.
Hapi 2
Hapet diskutimi:
- Renditni, çfarë keni veshur.
- Cili është materiali me të cilin është punuar xhupi/bluza juaj?

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën që do të trajtojmë. Nxiten nxënësit që në grup të analizojnë skemën e fibrave tekstile. Përmes stilolapsit në mes, caktohen nxënësit që duhet të lexojnë paragrafët. Pas leximit të paragrafit, nxënësi/ja në fjalë duhet të japë sqarime, të shtrojë pyetje dhe t'u përgjigjet pyetjeve që shtrojnë nxënësit (nëse nxënësi/ja është i/e paqartë, ndërhyn mësuesi/ja). Në këtë mënyrë, analizohet njësia mësimore.
Hapi 3
Pasi nxënësit të kenë informacione për llojet e fibrave të tekstilit, u kërkohet që në listat e veshjeve që krijuan në pjesën hyrëse të orës, të shënojnë materialin e veshjeve që kanë listuar (nuk gjykohen për pasaktësinë). U ofrohen nxënësve materiale të ndryshme prej pambuku/leshi/sintetike që t'i prekin dhe t'i krahasojnë ato.
Hapi 4
Në pjesën përfundimtare të orës, nxënësit plotësojnë kërkesën e detyrës në tekstin e nxënësit.
- Plotëso skemën me llojet e fibrave.

Bimore	1.	2.
Shtazore	1.	2.
Sintetike	1.	2.
Artificiale	1.	
Minerale	1.	2.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit dhe plotësimin e saktë të skemës.

Detyrë shtëpie

Hulumto në internet për informacione shtesë për temën e trajtuar.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan procesin e qethjes, larjes, pastrimit dhe krehjes së leshit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1,6,8; III.1,2; IV.7,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1; 3.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Procesi i qethjes, larjes, përpunimit dhe krehjes së leshit			
Fjalët kyçe: leshi, qethje, larje, përpunim, krehje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - **përcakton saktë kafshën prej** **së cilës** marrim fibrën e leshit; - analizon në bashkëpunim procesin e përpunimit të leshit; - reflekton, duke vizatuar veshje prej fibrave të leshit. **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësve, burime nga interneti, lapsi, ngjyrat etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ. Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja paraqet në projektor ilustrimin dhe shtron pyetjen: Shikoni figurën dhe thoni se leshi i cilës prej kafshëve përdoret në vendin tonë, për të prodhuar fibrën tekstile të leshit.  Nxënësit qarkojnë kafshën (në tekstin e tyre) që mendojnë se i përgjigjet kërkesës dhe arsyetojnë mendimin. Në këtë mënyrë, arrijmë te delja.			

Hap 2

Njoftohen nxënësit me temën që do të trajtohet dhe rezultatet e pritshme. Pasi nxënësit në grup analizojnë përpunimin e leshit dhe diskutojnë para klase, arrijnë në përfundim se:

1. Qethja bëhet me gërshërë ose makineri.
2. Grumbullohet në ambiente të përshtatshme ruajtjeje.
3. Kryhet procesi i larjes nga papastërtitë.
4. Realizohet krehja me dorë ose makineri.
5. Realizohet tjerrja me dorë ose makineri.
6. Kryhet procesi i ngjyrosjes me dorë ose makineri.
7. Enden fijet e leshit dhe kthehen në tekstil.

Hapi 3

Aktivitet: Vizatoni veshje, që përbëhen nga fibra prej leshi.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit dhe saktësinë e plotësimit të kërkesave.

Detyrë shtëpie

Sjell në klasë material/fibra leshi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan procesin e kultivimit, tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.6; III.2,4; V.8; VI.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Procesi i tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut			
Fjalët kyçe: larje, krehje, ngjyrosje, endje e pambukut, pëlhurë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon çfarë di për bimën dhe përpunimin e pambukut; - analizon tekstin në bashkëpunim me grupin; - sqaron procesin e përpunimit të pambukut, **në mënyrë kronologjike.** **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Material pambuku, ilustrime, teksti i nxënësit, organizuesi grafik.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Shkencat e natyrës. Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja paraqet ilustrime të bimës së pambukut (mund të përfshijë edhe ato në tekst apo imazhe nga interneti).

- Çfarë bime është? (nxënësit kanë njohuri paraprake nga njësitë e mëparshme)
- Për çfarë e përdorë njeriu pambukun?
- Çfarë dini ju për përpunimin e pambukut?

Pasi nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve të shtruara, arrijmë te tema që do të trajtojmë.

Hapi 2

Njoftohen nxënësit me temën që do të trajtohet. Analizon secili grup tekstin, u ofrohet nga një ilustrim i përpunimit të pambukut dhe u kërkohet ta ilustrojnë me informatat që kanë marr nga paragrafi i caktuar. Prezantimi i punës së grupit bëhet në mënyrë kronologjike.

Ilustrimi	Informacioni
	Vilet pambuku dhe dërgohet në punishte për t'u përpunuar.
	Pastrohet... _____ _____

	Tjerret... _____ _____
	Ngjyroset... _____ _____
	Thuret... _____ _____

Hapi 3

Diskutim i përbashkët:

(Secilit grup, mësuesi/ja u ofron material pambuku, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi ta prekin dhe ta dallojnë nga materialet tjera.)

- Shiko veshjen tënde dhe të shokut/shoqes. Diskutoni me njëri-tjetrin prej çfarë materiali përbëhen veshjet.
- Prekini dhe dallojini, a janë prej pambuku apo të leshta?
- Çfarë vetish ka secila fibër? Kush është më e ngrohtë?
- Cila thith më shumë lagështirë? Cila është më e lehtë?
- Cila thahet më shpejt?
- Mbaj shënime dhe jep vlerësimin tënd.
- Orjentohen nxënësit të hapin fletoren e punës në f.9 dhe me materialin e paraqitur në fillim të orës të punojnë delen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën dhe prezantimin e procesit t*ë* tjerrjes, ngjyrosjes dhe endjes së pambukut.

Detyrë shtëpie

Hulumto veshjet e tua, duke u bazuar në etiketa (pambuk/coton, lesh/wool) dhe sill informacionin në klasë sa veshje ke me fibra pambuku dhe sa, me fibra leshi.

Sill në klasë veshjet prej pambuku/leshi, që nuk i përdor më.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre		**Rezultati i të nxënit të temës**: Modelon objekte nga letra dhe kartoni.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.6; III.2,4; IV.2,5; V.8; VI.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 3.2; 9.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Riciklime me material leshi dhe pambuku			
Fjalët kyçe: riciklim, material leshi/pambuku, produkt, krijim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - organizon punën për punë praktike; - krijon produkte me materiale ricikluese; - argumenton punën e bërë në grup para klase. **Kriteret e suksesit:** I cakton mësuesi/ja bashkë me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit, burime nga interneti, mjete pune (gërshërë, gjilpërë, shkumës, spango etj.), veshje që nuk përdoren.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Matematikë Çështjet ndërkurrikulare: Edukim për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Njoftohen nxënësit me punën praktike, të cilën do ta zhvillojnë mësimin. Nxiten nxënësit të diskutojnë për rëndësinë e riciklimit dhe mbrojtjes së ambientit (për të bërë ndërlidhjen me punën praktike që do të kryejnë). Hapi 2 Nxënësit paraqesin veshjet që nuk përdorin (të udhëzuar orën e kaluar për t'i sjellë në klasë) dhe mjetet e punës. Pasi nxënësit analizojnë shembujt e ofruar në tekstin e nxënësit dhe në fletoren e punës f. 10. Mësuesi/ja paraqet në projektor burimet nga interneti të punës praktike, me materiale të tilla. Secili grup përcaktohet për punën që do të bëjë dhe ndajnë përgjegjësitë (puna praktike do të vazhdojë edhe në shtëpi).			
Gr. 1	Gr. 2	Gr.3	
			

Gr. 4

Gr. 5

(Nxënësit punojnë gjatë javës, për ta përfunduar dhe ekspozuar në orën e ardhshme punimin.)

Hapi 3
Turi i galerisë
Bëni një ekspozitë me punimet tuaja në klasë.

- Jep mendimin tënd, pse është e rëndësishme të riciklohen materialet?
- Po shoku/shoqja, çfarë mendimi ka?

Nxënësit, pasi kanë paraqitur punimet në ekspozitë, sqarojnë dhe diskutojnë për procesin e punës, vështirësitë dhe përparësitë që kishte krijimi i produktit me materiale ricikluese.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohet puna praktike në klasë, bashkëpunimi brenda grupeve, përdorimi i mjeteve të punës, si dhe prezantimet gjatë ekspozitës.

Detyrë shtëpie

U jepen nxënësve disa adresa interneti për punë praktike (me materiale leshi/pambuku, letër/karton,), që të punojnë produkte të thjeshta.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës**: Përshkruan burimet kryesore të rreziqeve nga pajisjet dhe instalimet e ndryshme elektrike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,5,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rreziku nga pajisjet elektrike			
Fjalët kyçe: rrezik, rrymë elektrike, spina, priza, elektroshtëpiake, mbrojtje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon rrezikun që i kanoset fëmijës **në ilustrim**; - sqaron rrezikun nga elektriciteti nga pakujdesia; - vlerëson situata të ndryshme **për** sigurinë nga elektriciteti. **Kriteret e suksesit:** I **përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Material shtesë nga interneti (organizues grafik), ngjyrat e drurit, teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetën.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja paraqet ilustrimin para nxënësve dhe u kërkon të diskutojnë dhe ngjyrosin me ngjyrë të kuqe rrezikun që i kanoset fëmijës tek ilustrimi.

Në këtë mënyrë, arrijmë te tema që do të trajtohet.

Hapi 2

Analizohet në grup rreziku nga elektriciteti, duke u bazuar në shembujt e paraqitur në tekstin e nxënësit. Hapet diskutimi, ku nxënësit thonë përfundimet që kanë nxjerrë gjatë punës në grup.

Hapi 3

Në pjesën e fundit të orës, nxënësit nxiten të lidhin informacionet me jetën e përditshme, duke u përgjigjur pyetjeve:

- Si vepron në shtëpi kur duhet të ngrohësh bukën, të thash flokët, të ndihmosh duke fshirë në punët e shtëpisë? - Çfarë kujdesi tregon? - I kryen këto veprime në prani të të rriturve në familjen tënde? *Po, pse? Jo, pse?* Në vazhdim, punohet detyra në tekstin e nxënësve, ku nxënësit duhet të shikojnë fotot të krahasojnë/vlerësojnë veprimet që shohin në foto dhe të shkruajnë për veprimet e fëmijëve.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen nxënësit për analizën e tekstit dhe vlerësimin e veprimeve në pjesën e fundit *të orës.*
Detyrë shtëpie
Rendit gjërat që nuk duhet të bësh, që të mos rrezikohesh nga elektriciteti.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Zbaton rregullat e përdorimit të drejtë të pajisjeve elektrike: prizat, çelësat, poçet, përçuesit etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,5,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rregullat e parandalimit të rreziqeve nga pajisjet elektrike			
Fjalët kyçe: rrezik, parandalim, rregulla, kordon, rryma elektrike.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - rendit veprimet per mbrojtjen nga rreziku nga elektriciteti; - analizon tekstin/situatat për mbrojtjen nga rreziku nga elektriciteti; - plotëson saktë tabelarin për mbrojtjen nga rreziqet nga elektriciteti. **Kriteret e suksesit:** I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Material shtesë nga interneti (organizues grafik),teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Nxiten nxënësit të diskutojnë për detyrat e shtëpisë, të cilat ishin: Rendit gjërat që nuk duhet të bësh, që të mos rrezikohesh nga rryma elektrike. Pasi nxënësit thonë njohuritë për mbrojtjen nga rreziqet nga rryma elektrike, mësuesi/ja paraqet ilustrimi dhe u kërkon nxënësve të bëjnë zgjedhjen e duhur, sipas kërkesës së detyrës.



Hapi 2

Hapen librat, njihen nxënësit me temën që do të trajtohet dhe rezultatet e të nxënit. Bëhet leximi i tekstit nga ana e nxënësve. Nxënësi/ja që lexon tekstin (paragrafin):

- sqaron me pak fjalë atë që ka lexuar;
- u përgjigjet pyetjeve të nxënësve;
- shtron pyetje rreth asaj që ka sqaruar.

Një gjë e tillë përsëritet derisa të analizohet i tërë teksti dhe ilustrimet përcjellëse.

Në vazhdim, u kërkohet nxënësve të pasurojnë listën (e diskutuar në pjesën hyrëse të orës) me rregullat e reja që morën për mbrojtjen nga rreziqet nga pajisjet elektrike.

Hapi 3

Diskutim në klasë:

- Pse nuk duhet të vendosim spinën vetë në prizë?
- Çfarë rreziku paraqet?
- Cilat janë rregullat që ndiqen për të qenë të sigurt që të mos na zërë rryma elektrike?

Detyrë: Plotëso tabelën.

	Rreziku	Mbrojtja
Spina		
Priza		
Kordoni		

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit, diskutimin dhe plotësimin e saktë të detyrës.

Detyrë shtëpie

Plotëso kërkesën në fletoren e punës f. 11.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa preventive për parandalimin e tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rreziqet dhe mbrojtja nga zjarri			
Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, zjarr, mbrojtje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - krijon një ngjarje të shkurtër, duke u bazuar në situatat në ilustrime; - analizon tekstin në bashkëpunim me grupin; - plotëson **kërkesën e detyrës**, duke u bazuar në situata nga jeta e përditshme. **Kriteret e suksesit**: I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Material shtesë nga interneti, https://www.pinterest.com/pin/516084438552617073/organizues grafik, teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja paraqet në projektor ilustrimet dhe u kërkon nxënësve të krijojnë një ngjarje të shkurtër, duke u bazuar në situatat në ilustrime.



Lexohen disa punime të nxënësve.

Hapi 2

Njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit. Secilit grup i caktohet pjesa që duhet lexuar dhe analizuar para klasës (gjë që bëhet në mënyrë zinxhir prej paragrafit të parë dhe në vazhdim).

Hapi 3
Diskutim i përbashkët
Duhet të përdorësh mjete ndezëse në shtëpi/shkollë? Argumentoni përgjigjen.
Kanë ndodhur raste të rënies së zjarrit nga pakujdesia? Si është vepruar?
Hapi 4
Detyrë:
Shkruaj një rast të rënies së zjarrit që ke parë (në jetën e përditshme, në film vizatimorë, internet etj.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për bashkëpunimin në grup si dhe për analizën e mirëfilltë *të tekstit.*

Detyrë shtëpie

Përgatit pamflete me këshilla për mbrojtjen nga zjarri, për t'i ekspozuar në klasë/korridor të shkollës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtyre rreziqeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Rreziqet nga lartësitë ballkoni, pusetat, shkallët
Fjalët kyçe: rrezik, kujdes, lartësi, pusetë, ballkon.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton për rrezikun që i kanoset fëmjës **në ilustrim**; - analizon tekstin në bashkëpunim me grupin; - paraqet para klase informacionet e përpunuara në grup. **Kriteret e suksesit:** I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime (burime nga interneti), teksti i nxënësit, fletorja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetën.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Hapi 1 Mësuesi/ja paraqet ilustrimin para nxënësve dhe shtron pyetjen: - Çfarë rreziku i kanoset fëmijës në ilustrim? Përmes diskutimit të përbashkët, mësuesi/ja orienton nxënësit në temën që do të trajtohet, *Rreziku nga lartësitë*. Hapi 2 Hapen librat, njihen nxënësit me njësinë mësimore, si dhe me rezultatet e të nxënit që do të arrihen. U ofrohet secilit grup nga një situatë, të cilën duhet ta analizojnë dhe ta sqarojnë para klasës. Grupi i parë duhet të sqarojë rrezikun në ballkon. Grupi i dytë sqaron rrezikun nga dritarja e hapur. Grupi i tretë sqaron rrezikun nga ngjitja në pemë. Grupi i katër sqaron rrezikun nga pusetat. Grupi pestë sqaron rrezikun nga shkallët. Mësuesi/ja jep sqarime shtesë, nëse grupet nuk arrijnë të japin sqarime të mjaftueshme.

Hapi 3 Hapet diskutimi në klasë për të lidhur përvojat e tyre nga jeta e përditshme me rrezikun nga lartësitë duke shtruar pyetje si: - Ju ka ndodhur të rrëzoheni nga lartësia? - Nëse po, si keni vepruar? Nxënësit shprehen, duke treguar raste nga përvoja e tyre apo që kanë parë ose dëgjuar nga të tjerët.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohet puna në grup. Bëhet vlerësim i ndërsjellët i grupeve me komente për analizën e tekstit.
Detyrë shtëpie
Nuk ka nevojë për detyrë shtëpie.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon rrezikun nga lëvizjet e pakujdesshme në pjesët e larta të objekteve të banimit, ballkone, kulme, ashensorë, pastaj puse, puseta etj., si dhe masat preventive për mënjanimin e këtyre rreziqeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve			
Fjalët kyçe: lartësi, pusetë, ballkon, masa mbrojtëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - thotë çfarë di për rreziqet dhe mbrojtjen prej tyre; - analizon tekstin, duke plotësuar tabelën me informacionet që di/dëshiron të dij**ë** dhe informacionin që ka mësuar; - përgatit/inskenon një lojë në grup me këshilla për mbrojtjen nga rreziqet. **Kriteret e suksesit:** I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime (burime nga interneti), teksti i nxënësit, fletorja.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetën.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1
Mësuesi/ja shtron pyetjen:
- Çfarë u vjen në mendje kur dëgjoni fjalën ***rrezik***?



Më pas, nxënësit tregojnë ato që dinë për rreziqet dhe nxiten që të diskutojnë për mbrojtjen prej tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë te tema që do të trajtojnë.
Hapi 2
Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit, që do të arrihen.
Analizohet teksti, njëkohësisht duke plotësuar tabelën e mëposhtme.

Di	Dua të di	Mësova

Në kolonën e parë, "Di", nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi iu duket si i njohur.
Në kolonën e dytë, "Dua të di", do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër.
Në kolonën e tretë, " Mësova", nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti.

Hapi 3
Diskutim
- Cilat janë rregullat që duhet të zbatohen për të shmangur rreziqet nga lartësitë?
- Pse duhen zbatuar ato? Çfarë ndodh nëse tregohemi të pakujdesshëm?

Lojë në grupe: Inskenoni në grupe të vogla një ngjarje të rrezikut nga lartësia dhe jepni këshilla për masat mbrojtëse (lojën paraqiteni para klase).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen *për* analizën e tekstit, diskutimin rreth temës, si dhe për lojën në grup.

Detyrë shtëpie

Bëj një fletushkë me këshilla për mbrojtjen nga rreziqet.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon disa nga substancat kryesore kimike dhe mjetet shpërthyese që mund t'i hasë nxënësi/ja në shtëpi, shkollë, terren të hapur etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Substancat kimike dhe kujdesi ndaj tyre			
Fjalët kyçe: substancë, solucion kimik, rrezik, kujdes, mjete mbrojtëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton me shokun në krah njohuritë që kanë për substancat kimike; - identifikon masat mbrojtëse për përdorimin e solucioneve me substanca kimike; - plotëson saktë detyrën e dhënë. **Kriteret e suksesit:** I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ilustrime (burime nga interneti), teksti i nxënësit, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja mund të fillojë mësimin me një lojë, ku nxënësit lëvizin lirshëm nëpër klasë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: *Çfarë janë substancat kimike?* Në momentin që jepet komanda: STOP! nxënësit kapen në dyshe përballë njëri-tjetrit dhe shkëmbejnë mendime rreth pyetjes. Në përfundim, mësuesi/ja pyet: Çfarë mësuat nga shoku/*shoqja?* Nxënësit thonë njohuritë që kanë marrë prej njëri-tjetrit, në këtë mënyrë arrijnë te tema që do të trajtohet. Hapi 2 Mësuesi/ja paraqet ilustrimin dhe kërkon nga nxënësit ta komentojnë. Çfarë bën vajza? Pse bart syze dhe doreza?			

(Në këtë mënyrë, orientohen nxënësit drejtë rrezikut nga substancat kimike.)

Hapi 3

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit që do të arrihen. Lexohet teksti nga ana e nxënësve dhe nxitet diskutimi përmes pyetjeve.

- Çfarë ndodh në familjen e fëmijëve gjatë fundjavës?
- Çfarë përbërjeje kanë solucionet që ata përdorin?
- Sa të rrezikshme janë ato?
- Cilat janë pasojat nga pakujdesia?
- Si duhet të kujdesemi kur i përdorim këto substanca?

Hapi 4

Detyrë: Rrethoni dhe shkruani etiketën e solucionit larës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për bashkëpunimin në çift dhe në grup, si dhe për analizën e tekstit.

Detyrë shtëpie

Diskuto me prindërit për solucionet që keni në shtëpi, të cilat nuk duhet t'i prekni.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Rreziqet dhe mbrojtja prej tyre		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon shkaqet potenciale për shpërthimin e zjarrit dhe merr masa preventive për parandalimin e tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.2,4; III.2,3,9; IV.4,8; V.7; VI. 2,8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1; 6.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizitë në reparti e zjarrfikësit			
Fjalët kyçe: zjarrfikës, rrezik, fikse zjarri, numri i emergjencës së zjarrfikësve.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - shtron pyetje të ndryshme për t'u informuar për temën; - sqaron informacionet e marra përmes lojës; - krijon një ngjarje, duke integruar informacionet e reja. **Kriteret e suksesit:** I plotëson mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet **ndërkurrikulare:** Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Nxënësit vendosen në tryeza rrethore. Një letër dhe një laps pasohet sistematikisht rreth grupit. Secili nxënës shkruan një pyetje që do të donte t'i shtronte një zjarrfikësi, nëse do të vizitonte institucionin e zjarrfikësve. Nxënësit lexojnë pyetjet që kanë përgatitur dhe në këtë mënyrë arrihet te tema që do të trajtohet. Hapi 2 Hapen librat dhe nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Pasi të lexohet teksti dhe analizohen ilustrimet, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në grup të improvizojnë një lojë skenike. Nxënësit ndajnë rolet në grup (zjarrfikësi, manekini i përfshirë në zjarr, zjarrfikësi që jep udhëzime etj.), mësuesi/ja u ofron kapelën dhe pajisjet të zjarrfikësve (lodra apo të improvizuara me letër sipas mundësive). U ofrohet pesë minuta kohë që grupet të inskenojnë diçka dhe ta paraqesin para klasës. Grupi që paraqet njohuritë e marra për veprimet e zjarrfikësit merr më shumë duartrokitje dhe shpallet grupi fitues (nxënësit përmes lojës në role thonë informacionet për mbrojtjen dhe masat preventive në rast rreziku nga zjarri). Si këshillat e xhaxhi zjarrfikësit – Nëse shikoni zjarr, dilni në korridor ose jashtë dhe bërtisni "Zjarr!", për të njoftuar anëtarët e familjes/fqinjët apo shokët/shoqet. – Telefononi në numrin 93 dhe jepni të dhëna konkrete. – Nëse zjarri ka vëllim më të madh, braktisni banesën/klasën. – Njerëzit e lënduar nga zjarri duhen dërguar sa më shpejt për të marrë ndihmën e mjekut.			

Hapi 3
Detyrë: Krijo një ngjarje, duke u bazuar në situatat në ilustrim.

Hapi 4
Kohën e mbetur në dispozicion nxënësit orientohen në fletoren e punës f. 12, që të plotësojnë kërkesën e detyrës.

_____
_____
_____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për analizën e tekstit, punën në grup dhe reflektimin në mënyrë individuale.

Detyrë shtëpie

Puno detyrën në fletoren e punës f. 13.
(Me kubin e formuar në shtëpi nxënësit do të luajnë lojën në f. 15 në fletoren e punës.)

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Karriera ime		**Rezultati i të nxënit të temës:** Prezanton para klasës, përmes TIK-ut, imazhe që ndërlidhen me punën dhe profesionet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.3; III.1,2,3,4,8; V.7,8; VI.4,5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1,2; 7.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Profesionet që njoh			
Fjalët kyçe: profesion, polic, okulist, mjek, mësues, hidraulik, postier, marangoz, elektricist, infermiere.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - prezanton para klasës, **përmes TIK-ut**, profesionin e prindërve; - dallon rëndësinë e secilit profesion që trajton; - argumenton mendimin e tij rreth çështjes së shtruar për diskutim. **Kriteret e suksesit:** I përcakton **mësuesi/**ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, projektori, burime nga interneti apo ilustrime për profesionet, teksti **i nxënësit**.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet ndërkurrikulare: Njohja e medias (përdorimi i medias për ta kuptuar botën përreth).			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja prezanton para klase në projektor, profesione të ndryshme që janë të shoqëruara edhe me mjetet e tyre të punës. Hapi 2 Lexohet paragrafi i parë në tekst. Mësuesi/ja shtron pyetjen: - Po prindërit tuaj, çfarë profesioni ushtrojnë? Rikthehemi përsëri te profesionet që u prezantuan në projektor dhe u kërkohet nxënësve të dalin para klase (përmes stilolapsit në mes) dhe të paraqesin profesionin e prindërve të tyre përmes imazheve të paraqitura në projektor, duke sqaruar edhe mjetet e punës, të cilat përdorin. Hapi 3 Në tekst janë paraqitur fotografi të profesioneve të ndryshme dhe u kërkohet nxënësve të shikojnë fotografitë dhe të shkruajnë profesionin përkatës. Pas diskutimit dhe sqarimeve që marrin nxënësit për profesione të ndryshme, arrijnë në përfundimin se çdo profesion ka rëndësinë e vet. Hapi 4 Diskutim: Si ndikojnë në jetën tënde profesionet që diskutuam? A mund të bëjë një njeri çdolloj profesioni? *Po, pse? Jo, pse?* Shkruaj profesionet që mund të bëhen edhe nga burrat, edhe nga gratë. _____ _____			

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen për diskutimin dhe analizën e përmbajtjes.
Detyrë shtëpie
Diskuto me prindërit për profesionet që ata ushtrojnë dhe plotëso fletoren e punës f. 16.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Karriera ime		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon përmes objekteve/institucioneve llojet e vendeve të punës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.3; III.1,2,3,4,7,8; V.7,8; VI.4,5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1; 7.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vendi i punës sipas profesionit			
Fjalët kyçe: vendi i punës, teatër, bibliotekë, shkollë, akademi shkencash, punishte qumështi.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - improvizon lojë në role, sipas profesionit të caktuar; - dallon vende të ndryshme pune, sipas profesionit që ushtrojnë; - shkruan saktë institucionin në të cilin kryhet një profesion i caktuar. **Kriteret e suksesit**: I përcakton **mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Mjete të ndryshme pune të profesioneve (lodër apo të punuara prej letrës), teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Secilit grup i ofrohen mjete të ndryshme të profesioneve të caktuar (mjete ekzistuese në klasë, të punuara në klasën e dytë nga nxënësit apo të punuara nga mësuesi/ja me letër). U kërkohet nxënësve të luajnë për 5 minuta lojë në role, sipas profesionit përkatës. Pasi përfundon koha, mësuesi/ja shtron pyetjen: - Çfarë profesioni ushtrohet në këtë grup? - Si quhet vendi ku ju ushtroni profesionin tuaj? - Çfarë profesionesh të tjera ushtrohen në këtë institucion? Në këtë mënyrë, arrihet te tema që do të trajtohet.			

Hapi 2

Hapen librat, njoftohen nxënësit me temën që do të trajtohet dhe me rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Lexohet teksti me ndalesa dhe pas secilës ndalesë, pasojnë pyetjet. Në këtë mënyrë veprohet për secilin paragraf dhe arrihet në përfundim se:

Shumë prej profesioneve kryhen në një ndërtesë të caktuar. Aktori e kryen aktivitetin në godinën e teatrit. Shkencëtarët e fushave të ndryshme i kryejnë studimet në Akademinë e Shkencave. Kur duhet të lexojmë libra të ndryshëm, mund t'i marrim në bibliotekën e qytetit/lagjes.

Vazhdohet me radhë për profesionet e ndryshme.

Hapi 3

Shiko fotografitë. Cilit vend pune i përket? Shëno profesionin që kryhet në to.

_____ _____ _____

Në fund, u kërkohet nxënësve të përfytyrojnë dhe përshkruajnë si do të dëshirojnë të ishte vendi i punës së tyre në të ardhmen.

_____

Disa punime të nxënësve lexohen dhe diskutohen para klasës. Në vazhdim nxënësit punojnë në fletoren e punës f. 17 dhe 19, ku presin dhe ngjesin etiketat në vendet përkatëse.

(Mundësisht të bëhet një vizitë e shkurtër te cilido profesion: *bukëpjekës, parukiere, avokat*, ku nxënësve u ofrohet mundësia të shohin vendpunimin, punën dhe mjetet që ata përdorin për të ushtruar profesionin e tyre. Nxënësit reflektojnë në klasë informacione për vendin e punës, mjetet dhe procesin e punës.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në grup, analizën e përmbajtjes, si dhe për plotësimin e saktë të kërkesave të detyrave të dhëna.

Detyrë shtëpie

Të rendisin pesë vende pune dhe të tregojnë cilat profesione ushtrohen aty.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Karriera ime		**Rezultati i të nxënit të temës:** Paraqet shkathtësi dhe dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.3; III.1,2,3,4,7,8; V.7,8; VI.4,5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1; 7.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Profesioni që më pëlqen			
Fjalët kyçe: profesion, mjek, mësues, veteriner etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - thotë **përmes lojës**, profesionet që di; - zbulon profesionet në tangram; - komenton përzgjedhjen e profesionit të caktuar. **Kriteret e suksesit:** I përcakton **mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Boshti numerik në dysheme, teksti i nxënësit. Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi **për zhvillim të qëndrueshëm.**			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Ora fillon përmes lojës, ku nxënësit duhet të numërojnë me hapa sa profesione njohin. Në raundin e dytë, do të thonë sa mjete pune apo pajisje të profesionit të caktuar njohin. Grupi që thotë sa më shumë profesione dhe mjete apo pajisje, fiton lojën.

Hapi 2

Hapen librat, njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Lexohet paragrafi, nxënësi/ja që lexon tekstin, duhet të sqarojë atë çfarë ka lexuar, t'u përgjigjet pyetjeve që i shtrojnë shokët/shoqet dhe të pyes shokët/shoqet rreth asaj që ka shpjeguar.

Në vazhdim, nxënësit, në grup, plotësojnë diagramin dhe detyrën tjetër në tekst, ku duhet të bashkojnë profesionin me mjetet e punës.

Hapi 3

Diskutim:

Mund të themi që ka profesione më të rëndësishme se ato që diskutuam? *Po, pse? Jo, pse?*

Cili është profesioni që ke dëshirë të ushtrosh në të ardhmen? Arsyeto përzgjedhjen tënde.

Profesioni	Komenti

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen nxënësit për përgjigjet që japin gjatë diskutimit.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet për profesionin që ke zgjedhur dhe sill informacione në klasë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Karriera ime		**Rezultati i të nxënit të temës:** Krijon një projekt të vogël me materiale të ndryshme, që lidhen me profesione të caktuara.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.3; III.1,2,3,4,7,8; V.7,8; VI.4,5			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1; 7.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Projekt. Unë do të bëhem...			
Fjalët kyçe: karrierë, profesion.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton për profesionet që sheh në projektor; - bashkëpunon në grup për realizimin e projektit; - punon me përgjegjësi punën praktike, duke u bazuar në obligimin e marr nga grupi; - prezanton punën praktike në bashkëpunim me grupin. **Kriteret e suksesit:** I përcakton **mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, projektori, burime nga interneti apo ilustrime për profesionet, teksti **i nxënësit**.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet ndërkurrikulare: Zhvillimi personal dhe shkathtësi për jetën.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Ora mbahet në kabinetin e TIK-ut (nëse nuk është e mundur, atëherë mësuesi/ja përgatit informacionet paraprakisht). Hapi i parë fillon duke vendosur në sfond (në projektor) shembuj të profesioneve të ndryshme, me imazhe të vendpunimit dhe të shfrytëzimit të mjeteve të punës. Në këtë mënyrë, nxiten kureshtja dhe kreativiteti te nxënësit, për të hulumtuar për projektin në fjalë. Shtrohet pyetja: *Si të informohemi për karrierën?* Hapi 2 Hapen librat, njihen nxënësit me punën praktike (projekte të thjeshta), që do të bëjnë në bashkëpunim me grupin. Orientohen nxënësit të vrojtojnë shembujt në libër dhe në internet; diskutojnë për profesionet e caktuara, për të vazhduar me organizimin e punës në grup dhe ndarjen e përgjegjësive. Grupet e nxënësve përcaktohen për profesionin që do të hulumtojnë, përmes punës praktike në klasë dhe jashtë klase. Përveç të dhënave që kanë nxënësit në paragrafin e caktuar, grupet do të kenë në dispozicion 10 minuta kohë për analizë dhe hulumtim në internet, në mënyrë që të kenë idenë se: *Si do të hulumtojnë në internet? Çfarë do të hulumtojnë? Si do t'i prezantojnë materialet e gjeturat për profesionin e caktuara?*			

Hapi 3 Nxënësit punojnë të pavarur. Mësuesja/si do të jetë gjithnjë duke asistuar në secilin grup me sugjerime dhe ndihmë, aty ku është e nevojshme. Pasi nxënësit përfundojnë hulumtimet, diskutojnë për prezantimin e projektit, që do ta bëjnë orën e ardhshme, pasi kemi në dispozicion dy orë mësimore për të realizuar projektin. (Orën e dytë, prezantimi bëhet në forma të ndryshme, ashtu si nxënësit kanë hulumtuar gjatë javës. Ata, gjatë prezantimit të projektit të tyre, duhet të sqarojnë materialet e përdorura, punën praktike, përparësitë, vështirësitë, ecurinë e punës, bashkëpunimin në grup etj.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen për përdorimin e TIK-ut, bashkëpunimin, hulumtimet dhe prezantimet e projektit që bëjnë orën e dytë. Vlerësohen përmes listës së kontrollit.
Detyrë shtëpie
Bashkëpuno në grup për përgatitjen e prezantimit të projektit dhe plotëso fletoren e punës f. 20.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Planifikimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Kontribuon në ekonominë familjare	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.3,5,7; III.1,2,4,9; IV.3,6; V.3,8; VI.2,4,6,7			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 5.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ekonomia familjare			
Fjalët kyçe: market, shpenzoj, kosto, kursim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - planifikon një udhëtim/shëtitje në bashkëpunim (përmes lojës); - kalkulon shpenzimet për të pasur një kosto më të ulët; - tregon si vepron për të kontribuar në ekonominë familjare. **Kriteret e suksesit:** I **përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, projektori, burime nga interneti për koston e produkteve ushqimore, teksti **i nxënësit**.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Aktivitet

Ulen nxënësit në rreth dhe ora mësimore fillon me improvizimin e planifikimit të një udhëtimi/shëtitjeje. Nëse do të shkoje në një udhëtim/shëtitje, cila do të ishte gjëja e parë që do të merrje me vete?

Nxënësit, në mënyrë zinxhir, thonë një gjë që do të merrnin në udhëtim. Nxënësi/ja në krah përsërit fjalën që tha parafolësi e kështu me radhë. Në fund, duke u bazuar tek ato që u thanë, ata bëjnë listën e gjërave më të nevojshme që duhen marr në pushim.

Hapet diskutimi:

- Bëni planifikimin për një aktivitet të caktuar, si udhëtim, festë, ditëlindje.
- Si do ta bëni planifikimin?

Në këtë mënyrë, arrijmë te koncepti i planifikimit si kontribut në ekonominë familjare.

Hapi 2

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën që do të trajtohet e me rezultatet e të nxënit të njësisë mësimore. Bëhet leximi i tekstit me ndalesa. Pas secilës ndalesë, pasojnë pyetjet:

- Çfarë kërkuan fëmijët nga prindërit?
- Si vepruan fëmijët kur shkuan në market?
- Po ju si veproni, zgjidhni produkte me kosto më të ulët? Pse veproni ashtu?

Nxënësit bëjnë kalkulime shpenzimesh të përafërta në tekst dhe diskutojnë për rëndësinë e kursimit në ekonominë familjare.

Në këtë mënyrë, bëhet analiza e përmbajtjes dhe nxënësit arrijnë në përfundim se të kursyerit kontribuon në ekonominë familjare.

Hapi 3

Hapet diskutimi në klasë, duke u lexuar nxënësve thënien "Kursimi është kulturë".

Çfarë mendoni për thënien "Kursimi është kulturë"?

Pasi nxënësit diskutojnë për pyetjen e shtruar, u kërkohet që të shkruajnë në mënyrë individuale rreth kërkesës së detyrës, si më poshtë.

Shkruaj si ndihmon ti në uljen e shpenzimeve të familjes.

(Disa punime të nxënësve lexohen para klasës.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për diskutimin rreth temës.

Vlerësohen për punën grupore dhe individuale, si dhe bëhet vlerësimi i ndërsjellët për shkrimet në fund të orës.

Detyrë shtëpie

Diskuto me prindërit se si duhet kursyer për të kontribuar në ekonominë dhe plotëso fletoren e punës f. 21.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Planifikimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Organizon aktivitete argëtuese, humanitare, ruajtjen e mjedisit etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.3,5,7; III.1,2,4,9; IV.3,6; V.3,8; VI.2,4,6,7			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Organizimi i një feste			
Fjalët kyçe: festë, planifikim, organizim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - planifikon një aktivitet në bashkëpunim me grupin; - krijon një produkt sipas planifikimit të bërë në grup; - sqaron organizimin e një aktiviteti humanitar. **Kriteret e suksesit:** I përcakton **mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Materiale të ndryshme ricikluese, gërshërë, ngjitës, ngjyra, teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi. Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Pyetja e ditës: Si do ta planifikojmë organizimin e festave që po afrohen (Festa e Pavarësisë, festa e 8 Marsit)? U jepet kohë grupeve që në bashkëpunim të diskutojnë/hedhin në letër idetë dhe të thonë para klasës se si do ta bëjnë planifikimin e organizimit të festave në fjalë (lexohen disa punime të nxënësve). Hapi 2 Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të njësisë mësimore. Ata krahasojnë idetë e tyre me ato të dhëna në tekst dhe diskutojnë për ndryshimin; gjithashtu analizojnë shembujt e dhënë. Nxënësit bëjnë llogaritë e përafërta të shpenzimeve, për të krijuar dekorimet/urimet (kalkulimet bëhen në mënyrë që nxënësit të nxiten për kursimet në familje). Orientohen nxënësit përmes bisedave, që të dedikojnë dhuratat dhe urimet njerëzve në nevojë, në mënyrë që të nxitet ndjenja e humanizmit tek ata. Hapi 3 Nxënësit, të pavarur, fillojnë punën praktike në bashkëpunim me grupin duke u orientuar në fletoren e punës f. 22 dhe 23. Hapet diskutimi në klasë: Cili nga grupet e nxënësve e realizoi festën me më pak shpenzime? Pse duhet të përdoren materialet e ricikluesshme? Detyrë: Krijo një dhuratë sipas idesë sate. Realizoje dhe vlerëso sa të kushtoi. - Kujt do t'ia dedikosh dhuratën? - Si do ta organizoje ti një aktivitet humanitar?			

(Mësuesi/ja shfrytëzon rastin për të inkurajuar nxënësit që të marrin iniciativë për të planifikuar një aktivitet humanitar, p.sh. në shtëpinë e të moshuarve apo në një familje në nevojë.)
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen përmes listës së kontrollit.
Detyrë shtëpie
Sillni në klasë materiale të ndryshme të ricklueshme, që nuk ju nevojiten më.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Planifikimi		**Rezultati i të nxënit të temës:** Planifikon dhe punon një produkt prej materialeve ricikluese.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.3,5,7; III.1,2,4,9; IV.3,6; V.3,8; VI.2,4,6,7			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 5.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Punime me materiale të ricklueshme			
Fjalët kyçe: planifikim, materiale ricikluese.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - sqaron kuptimin e fjalëve riciklo/ripërdor/redukto me pak fjalë; -punon një produkt në bashkëpunim me grupin me materiale ricikluese; - paraqet punën e grupit dhe bëjnë vlerësimin e ndërsjellët. **Kriteret e suksesit:** l përcakton **mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit**.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, laptopi, burime nga interneti https://www.simplykinder.com/free-recycling-sort/, materiale të ndryshme ricikluese, teksti i nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurative. Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Mësuesi/ja paraqet ilustrime në sfond (projektor) të materialeve të ndryshme ricikluese dhe orientohet diskutimi rreth planifikimit të krijimit të një produkti me materiale ricikluese. Fillimisht, nxënësit thonë çfarë kuptojnë me fjalët *riciklo, ripërdor, redukto* dhe japin shembuj konkret.			



Shkruaj:

- tri artikuj që mund t’i riciklosh;
- dy artikuj që mund t’i ripërdorësh;
- një mënyrë që mund të reduktosh.

(Punimet e nxënësve vlerësohen me informatë kthyese.)

Hapi 2

Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të njësisë mësimore. Analizohen udhëzimet dhe ilustrimet për krijimet që do të bëjnë me materiale ricikluese (u ofrohen nxënësve edhe ide tjera në internet përveç atyre ekzistuese në tekst dhe në fletoren e punës f. 25 dhe 27). Fillimisht, secili grup do të planifikojë punën në grup, duke u kujdesur për planin e veprimit, materialet e nevojshme si dhe ndarjen e përgjegjësive për realizimin e projektit. Fillojnë nxënësit të punojnë sipas përzgjedhjes apo ideve të tyre personale, gjithmonë nën mbikëqyrjen e mësuesit/es. Nxënësit do të punojnë në projektin e tyre që ta kompletojnë gjatë javës dhe ta paraqesin para klase në orën e ardhshme, apo mund ta paraqesin në një datë të caktuar p.sh. në datën 22 Prill, në ditën e Tokës.

Hapi 3

Pasi të kenë punuar gjërat më të thjeshta që nuk kërkojnë shumë kohë, hapet diskutimi:

- Cili përgatiti dhuratën më të bukur?
- Si e realizuat këtë objekt? Sa kushtoi?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen për planifikimin që bëjnë në bashkëpunim me grupin.
Nxënësit bëjnë vlerësimin e ndërsjellët.
Vlerësohen përmes Listës së kontrollit.

Detyrë shtëpie

Përgatit një objekt me material të riciklueshëm për anëtarët e familjes.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		**Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon repartet, punishtet dhe pajisjet që prodhojnë zhurmë të lartë: si ato për përpunimin e drurit, të materialeve plastike etj., që gjenden pranë mjedisit jetësor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.3,6; III.1,2,3,4; IV.4,5; V. 1,8,9; VI.2			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 9.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Zhurmat në mjedis			
Fjalët kyçe: ndotje nga zhurma, bori, muzikë e lartë, zhurmë sharrimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton rreth ilustrimit të paraqitur në sfond; - analizon në çift llojet e zhurmave; - plotëson me shkrim kërkesën e detyrës së dhënë. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësve.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ. Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (shërbimet për bashkësinë).			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Paraqet mësuesi/ja fotografinë para nxënësve dhe shtron pyetjen: Çfarë ju shtyn të mendoni, fotografia që shihni? Nxënësit thonë mendimet e tyre, mësuesi/ja i shkruan ato në tabelë dhe orienton nxënësit për llojet e zhurmave. Në këtë mënyrë, nxënësit arrijnë te koncepti që do të trajtohet. Hapi 2 Hapen librat dhe nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Bëhet leximi i tekstit dhe nxënësit vendosin shenja identifikuese me plus për zhurmat që njohin dhe shenjën minus për zhurmat që ata i dëgjojnë më rrallë apo që nuk i dëgjojnë fare. Hapet diskutimi, ku çiftet për ca minuta diskutojnë për llojet e zhurmave që janë të njohura për ta dhe zhurmat që dëgjojnë më rrallë/nuk i dëgjojnë fare. Diskutimi në vazhdim bëhet frontal. - Cilat zhurma dëgjoni në jetën tuaj të përditshme? - Cilat janë zhurma të këndshme/pa këndshme për ju? Pse? - Si ndiheni në një ambient me zhurmë të madhe? - Si do të vepronit ju që mos të ketë zhurma në klasë/shtëpi/ambient? - Si mendoni, është ndotje e ambientit zhurma?			

Në këtë mënyrë arrijnë në përfundim se zhurmat janë ndotës të ambientit. Në vazhdim, nxënësit listojnë në libër llojet e zhurmave që shkaktohen në jetën e tyre të përditshme, duke u bazuar në shenjat e vendosura në libër gjatë leximit.

Hapi 3

Në pjesën përfundimtare të orës, u kërkohet nxënësve të plotësojnë kërkesën e detyrës në libër.

Detyrë: Përshkruaj versionin tënd.

- Pse është i shqetësuar djali në foto?
- Je ndodhur në një situatë të tillë dhe ti?

Disa punime të nxënësve lexohen para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për analizën dhe diskutimin rreth tekstit.

Detyrë shtëpie

Përshkruaj me 4-5 fjali sa është prezente zhurma në jetën tuaj të përditshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përpilon orarin e lojës apo të argëtimit në kohën kur nuk pengon në mjedisin jetësor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.4,5,6,9; IV.2,3,4,5; V. 1,2,8; VI.2,5,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 9.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Argëtohem në kohën e lirë			
Fjalët kyçe: kohë e lirë, aktivitet, orar argëtimi.			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- diskuton për lojën/aktivitetin që pëlqen;
- krijon orarin e aktiviteteve në bashkëpunim me grupin;
- planifikon me grupin aktivitetin që synon të realizojë gjatë javës.

Kriteret e suksesit:
I p**ërcakton mësuesi/**ja në bashkëpunim me nxënësit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Edukimi fizik sporti dhe shëndeti, Edukatë figurativ, Edukatë muzikore.
Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1
Ora mësimore fillon me një lojë brenda klase. Nxënësit lëvizin në klasë sipas udhëzimeve që thotë mësuesi/ja p.sh. "Mësuesi/ja thotë imito lojën e basketbollit/futbollit/tenisit/notit etj.". Nxënësit lëvizin sipas udhëzimeve të mësuesit/es. Në rast se nuk përmendet fjala "mësuesja/i thotë", nxënësit duhet të injorojnë udhëzimet e të vazhdojnë atë që ishin duke e bërë. Ai që gabon, nuk e vazhdon lojën. Pasi të përfundojë aktiviteti, mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Si u ndjeve gjatë lojës?
- Cili ishte aktiviteti/loja jote e preferuar?
- Si e kalon kohën e lirë?
- Pse të pëlqen të kalosh kohën duke…?

Përmes këtij aktiviteti, arrijmë te tema që do të trajtohet.
Hapi 2
Hapen librat dhe njoftohen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Lexohet teksti nga ana e nxënësve, diskutohet në mënyrë frontale dhe arrihet në përfundim se për realizimin e aktiviteteve, gjithmonë duhet të ketë një orar, në mënyrë që aktivitetet/lojërat të luhen në kohë të përshtatshme, që nuk pengon mjedisin jetësor. Nxënësit, duke u bazuar në orarin mostër në libër, përpilojnë një orar të aktiviteteve në fletoren e punës f. 29.

Hapi 3
Diskuto në klasë:

- Pse të pëlqejnë aktivitetet që zgjodhe?
- Çfarë rëndësie kanë në kalimin e kohës së lirë?
- Organizon aktivitete me shokët/shoqet? Po, çfarë lojërash pëlqeni? Jo, pse?

(Duke u bazuar në përzgjedhjet e aktiviteteve që nxënësit zgjedhin, formohen grupet dhe planifikojnë një aktivitet gjatë javës, në mënyrë që ta paraqesin para klasës orën e ardhshme. Aktivitetet mund të paraqiten në klasë apo në ambiente të hapura, varësisht në atë të orën të edukakës fizike.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve bëhet përmes Buletinit të pjesëmarrjes.

Detyrë shtëpie

Organizo një aktivitet kulturor/rekreativ në bashkëpunim me grupin dhe prezanto aktivitetin në klasë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan dëmet që shkaktohen në mjedis nga djegia e mbeturinave, tymtarët e fabrikave, lirimi i gazrave nga makinat etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.4,5,6,9; IV.2,3,4,5; V. 1,2,8; VI.2,5,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 9.2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbrojtja e mjedisit nga tymi			
Fjalët kyçe: ajër i ndotur, tymi makinave, sëmundje mushkërive.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - shqyrton konceptin, duke u bazuar në njohuritë e dhëna; - bashkëvepron me të tjerët p**ër të hulumtuar njohurit e reja;** - shkruajnë një përkufizim për konceptin e dhënë. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësve.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurativ. Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 **Teknika LINK** Vendoset koncepti kryesor "Ndotja e ajrit", nxiten nxënësit për përgjigje. Përgjigjet shënohen në tabelë, u kërkohet nxënësve që për tre minuta të renditin në fletore lidhjet për këtë përgjigje. Hapi 2 Nxiten nxënësit që të pyesin rreth termave të renditura në tabelë. Nxënësit mund të vënë në diskutim disa nga idetë e dhëna. Megjithatë, të gjitha pyetjet drejtohen për të ndjekur nxënësit, jo mësuesin. Qëllimi i përgjigjeve (të shpejta) është të bëjë që nxënësit, përmes pyetjeve që parashtrojnë, të bisedojnë me njëri-tjetrin dhe të arrijnë të zbulojnë temën. Hapi 3 Gjatë shqyrtimit dhe kërkimit, nxënësit bashkëveprojnë si për të shkëmbyer njohuritë, ashtu edhe për të zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi përgjigjen apo konceptin. Duhet t'u kujtojmë nxënësve të ndjekin rregullat gjatë diskutimit dhe të respektojnë njëri-tjetrin gjatë shqyrtimit të konceptit. Hapi 4 Kur nxënësit të kenë kryer plotësisht shqyrtimet dhe komentet e tyre për temën, i fshijmë ato që kemi shkruar në tabelë. M**ë**suesi/ja i udhëzon nxënësit të kthejnë mbrapsht fletët e tyre. Të vihet re çfarë kanë mësuar rreth fjalës treguese. Një mënyrë është që ata të shkruajnë një përkufizim për konceptin.			

Ajo çfarë ata shkruajnë, mund të bazohet si në përvojën e tyre, ashtu edhe në diskutimet në klasë gjatë hulumtimit. Tani nxënësit janë gati të lexojnë pjesën. Pas leximit, u kërkohet të shënojnë çfarë dinë që nga fillimi kur ndeshën në materialin e ri.

Hapi 5

Diskuto në klasë

Cilat janë arsyet që ndotet ajri? Po në komunitetin ku jeton, cilat janë arsyet e ndotjes së mjedisit?

Detyrë: Shiko fotografinë. Përshkruaj shkurt idenë që paraqet për ndotjen e mjedisit.

(Duke u bazuar në hulumtimet dhe përfundimet që nxorën, nxënësit, të pavarur, komentojnë ilustrimin **që** është në libër. Përmes stilolapsit në mes, disa punime të nxënësve lexohen para klasës.)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen përmes buletinit të pjesëmarrjes gjatë shqyrtimit/hulumtimit dhe përkufizimit që do të bëjnë.

Gjithashtu, vlerësohen për reflektimin në fund të orës.

Detyrë shtëpie

Ndotja e ajrit përbën një rrezik serioz për shëndetin e njeriut. Shkruaj cilat janë pasojat. Plotëso fletoren e punës f. 33.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		**Rezultati i të nxënit të temës:** Prezanton situatat e ndryshme se si bëhet mbrojtja e mjedisit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.4,5,6,9; IV.2,3,4,5; V. 1,2,8; VI.2,5,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 9.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kontribuoj në mbrojtjen e mjedisit			
Fjalët kyçe: mjedis i pastër, ujë i pastër, mbeturina.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton për veprimet e gabuara në tekstin e lexuar; - sqaron saktë tekstin, duke shtruar/përgjigjur pyetjeve; - shkruan një tekst të shkurtër, duke u bazuar në ilustrim.			

Kriteret e suksesit:
I **përcakton mësuesi/**ja në bashkëpunim me nxënësit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurativ.
Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1
Udhëzohen nxënësit të ulin kokat në bankë dhe të mbyllin sytë derisa dëgjojnë leximin e paragrafit të parë.
Mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Çfarë kuptuat nga ajo që u lexua?
- Çfarë ju erdhi në mendje kur dëgjuat ngjarjen?
- Keni parë ju situata të tilla?
- Si duhet reaguar në situata të tilla?
- Sa është e rrezikshme ndotja e ambientit për të gjithë globin?
- Cilat masa duhet marr për të mbrojtur mjedisin ku jetojmë?

Hapi 2
Pasi nxënësit njihen me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore, vazhdohet me leximin e përmbajtjes nga ana e nxënësve. Përmes stilolapsit në mes, përzgjidhet nxënësi/ja që lexon paragrafin në vijim. Nxënësi/ja që lexon pjesën e caktuar, duhet të bëjë sqarimin e asaj që ka lexuar, të shtrojë pyetje rreth përmbajtjes dhe t'u përgjigjet pyetjeve që i shtrojnë nxënësit rreth pjesës në fjalë. Njëjtë veprohet me paragrafët e tjerë.

Hapi 3
Në pjesën përfundimtare të orës, diskutohet rreth pyetjes së shtruar në libër, si dhe plotësohet rubrika:
Detyrë: Shiko figurën dhe shkruaj mendimin tënd për mbajtjen pastër të mjedisit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për analizën e tekstit dhe diskutimet në klasë.
Vlerësim i ndërsjellët Dy yje një dëshirë.

Detyrë shtëpie

Hulumto në internet për dëmet që i shkakton globit ndotja e ambientit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mjedisi dhe shëndeti		**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan prezencën e deponive, grumbullimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3; II.1; III.4,5,6,9; IV.2,3,4,5; V. 1,2,8; VI.2,5,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1; 9.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vendgrumbullimi i mbeturinave dhe riciklimi i tyre			
Fjalët kyçe: grumbullim, ndarje, riciklim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - diskuton për paranjohuritë rreth pyetjes së shtruar; - krijon skemën e ciklit të përpunimit të mbeturinave të ricikluesshme; - shkruan për grumbullimin e mbeturinave, duke u bazuar në njohuritë e fituara. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, teksti i nxënësve, *flipchart*, ngjyra druri, lapustil etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurativ. Çështjet **ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Pyetja e ditës: Çfarë ndodh me mbeturinat që grumbullojnë punonjësit e kompanisë së pastrimit? Paraqitet pyetja e ditës para nxënësve dhe u kërkohet që të diskutojnë në grup për pesë minuta dhe të paraqesin para klase paranjohuritë. Hapi 2 Hapen librat dhe njihen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Bëhet leximi i tekstit me ndalesa, pas secilës ndalesë pasojnë pyetjet: - Ku vendosen mbeturinat e grumbulluara? - Cilat janë pasoja nëse groposen mbeturinat nën tokë? - Si veprojnë punonjësit që të mos i groposin të gjitha mbeturinat? - Si bëhet klasifikimi i mbeturinave? - Pse bëhet një gjë e tillë? - - Si veprohet me mbeturinat e klasifikuara? Analizohen skemat e ciklit të përpunimit të mbeturinave prej letre dhe plastike. Shtrohen pyetjet: - Cili qenka cikli i përpunimit të mbeturinave prej letre dhe plastike? - Po cikli i përpunimit të mbeturinave prej qelqi, si bëhet? Në këtë mënyrë, nxënësit sqarojnë ciklet e përpunimit të materialeve të ricikluesshme.			

Hapi 3 Detyra në tekstin e nxënësve punohet në mënyrë individuale. Përmes stilolapsit në mes, disa punime të nxënësve lexohen para klasës. Hapi 4 Orjentohen nxënësit për punë praktike në fletoren e punës f. 30 dhe 31.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit vlerësohen për analizën e tekstit, si dhe bëhet vlerësimi i ndërsjellët i punës në grupe. Gjithashtu, nxënësit vlerësohen për detyrën e punuar në mënyrë individuale në fund të orës.
Detyrë shtëpie
Hulumto në internet për përpunimin e materialeve të ricikluesshme.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mediet		**Rezultati i të nxënit të temës:** Prezanton para klasës disa lloje mediesh që shikon në shtëpi për moshën e tij.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4,8; II.2,5; III.2,4,6; VI.2,4; VI.2,4			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e medieve			
Fjalët kyçe: Media, TV, radio, internet , gazeta, revista, libra etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon për mediet/emisionet që përcjell më shumë; - analizon në çift llojet e medieve dhe paraqet para klase përfundimet; - arsyeton përzgjedhjen e medies të pëlqyer. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, burime nga interneti, fletë A4, ngjyra, ngjitës etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore**:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Ed. Muzikore, Ed. Fizike sporti dhe shëndeti. Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1

Aktivitet

Secili nxënës duhet të tregon se cilat emisione televizive/internet/radio i shikon/dëgjon më së shumti (seri, filma të vizatuar, ndeshje sportive, emisione muzikore, filma artistikë, programe kontaktuese dhe emisione dokumentare shkencore...).

Secili nxënës mund ta zgjedhë vetë mënyrë sesi do ta shprehë mendimin e tij/saj, këtë mund ta bëjë përmes aktivitet shprehës:

- vizatimit (figurë, grafit, fotografi, kolazh etj.);
- të shkruarit (ese, dramatizim, vjershë, tekst për rep ose për ndonjë këngë tjetër etj.);
- pantomima (skeç, aktrimi i "skulpturës");
- shprehje me zë (fjalim).

Pasi të reflektojnë nxënësit, mësuesi/ja i mbledh të dhënat dhe i shkruan në tabelë emisionet e përmendura dhe llojin e medieve. Pranë secilit emision që përsëritet, vihet edhe nga një vizë.

Në fund, i mbledh vizat dhe e shpall se cili emision/media mesatarisht është më i shikuar/dëgjuar nga nxënësit e klasës.

Hapi 2

Vëzhgo-Analizo

Hapen librat dhe paraqitet tema dhe njihen nxënësit me rezultatet e të nxënit. U kërkohet nxënësve në çift të vëzhgojnë ilustrimet dhe të analizojnë paragrafin përkatës.

Gazeta

Televizori

Radio

Interneti

Pasi nxënësit, në çift, kanë analizuar paragrafët, i paraqesin fillimisht në grup informacione e pastaj në mënyrë frontale bëhet diskutimi. Në këtë mënyrë, arrijmë në përfundim se kemi media të shkruara, të shikuara dhe të dëgjuara.
Hapi 3
Diskuto dhe shkruaj: Cilat prej medieve është më e pëlqyer nga ju? Pse?

Nxënësit në mënyrë individuale arsyetojnë përzgjedhjet e tyre, duke plotësuar kërkesën në libër. Disa punime të nxënësve lexohen para klasës dhe në fund nxënësit plotësojnë në fletoren e punës f. 34.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Aktivitetet shprehëse në pjesën hyrëse të orës.
Analiza e paragrafëve në çift.
Puna individuale në pjesën përfundimtare të orës.

DETYRË SHTËPIE

Hulumto në internet për llojet e medieve, sille informacionin në klasë.
Sjell në bibliotekën e klasës revistat/librat që ka lexuar.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mediet		**Rezultati i të nxënit të temës:** Moderon aktivitete brenda klasës para prindërve për festa të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4,5,8; II.5; III.1,2,4,6,9; IV.3; VI.3,4,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 4.1			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtoj aktivitetin për festën e shkollës			
Fjalët kyçe: aktivitet, organizatorë, krijim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - krijon një shkrim, duke u bazuar në fjalët paraprake; - analizon përmbajtjen, duke e krahasuar me krijimet në fillim të orës; - plotëson shkrimin me ide dhe informacione të reja. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, burime nga interneti, fletë A4, ngjyra, ngjitës etj.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Ed. Muzikore, Ed. Fizike sporti dhe shëndeti.
Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi 1
U ofrohen nxënësve fjalët kyçe për të krijuar një shkrim, duke u bazuar në fjalët paraprake.



Përmes stilolapsit në mes, lexohen punimet e nxënësve. Në këtë mënyrë, arrijmë te tema që do të trajtohet.
Hapi 2
Hapen librat dhe njoftohen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Lexohet teksti dhe analizohet në bashkëpunim. Shtrohen pyetjet:

- Si e organizuan festën e shkollës nxënësit në tekst?
- Si i ndau mësuesi/ja detyrat?
- Çfarë bënë organizatorët e koncertit?
- Po modeluesit, çfarë detyre kishin?
- Cilat janë gjërat e veçanta që bëjnë në shkollën e tyre?
- Po në shkollën tuaj, cilat aktivitete bëni?
- Sa përshtatej shkrimi juaj që punuat në pjesën hyrëse të orës me planifikimin e festes në tekst?

Hapi 3
Pas diskutimit u kërkohet nxënësve të plotësojnë detyrën në tekst, në mënyrë individuale.
Detyrë: Shkruani idetë tuaja për përgatitjen e festës së shkollës suaj.
Nxënësit mund ta paraqesin shkrimin e tyre, duke e plotësuar me vizatime, skica të planifikimit etj.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes gjatë orës mësimore.

Detyrë shtëpie

Hulumto në internet për ide të reja mbi organizimin e festës së shkollës.
Shkruaj në fletore si do të kontribuosh në festën e shkollës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mediet		**Rezultati i të nxënit të temës:** Organizon aktivitete të lira në kuadër të grupeve kulturore brenda klasës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3,4,5,8; II.5; III.1,2,4,6,9; IV.3; VI.3,4,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 4.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Grupi letrar organizon "Orë letrare"			
Fjalët kyçe: libër, orë letrare, program, teknologji.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - hulumton në internet informacione për realizimin e orës letrare; - planifikon hapat e realizimit të orës letrare; - realizon orën letrare në bashkëpunim me shokët/shoqet e klasës. **Kriteret e suksesit:** I **përcakton mësuesi/**ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kompjuteri, Libra të ndryshëm si material për hulumtim, teksti i nxënësve.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Art figurativ, Ed. Muzikore. Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Ora fillon me hapjen e kompjuterëve për të hulumtuar poezi nga autorë të ndryshëm, apo për të shpalosur poezitë e vetëshkruara (në mungesë të kompjuterëve në klasë, mësuesja/i ofron libra të ndryshëm për të bërë hulumtimin e poezive).

Hapi 2

Hapen librat dhe njoftohen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Pasi të lexohet teksti, pasojnë pyetjet:

- Çfarë mendon për organizimin e "Orës letrare", që përgatitën nxënësit?
- Çfarë do të kishe shtuar apo hequr?
- Përshkruaj me pesë rreshta se si do të organizoje një orë letrare në klasën/shkollën tënde?

Hapi 3 Lexohen punimet e nxënësve dhe ata vendosin si do ta paraqesin orën letrare në klasë. Të gjeturat në internet/libra apo të vetëshkruara i paraqesin nxënësit para klase. Pra, shpalosin poezitë e zgjedhura në pjesën hyrëse të orës dhe për 20 minuta realizojnë orën letrare në klasë. Për të shoqëruar performancën e nxënësve vendoset në sfond muzikë e lehtë. Pas përfundimit, diskutohet për ecurinë e orës letrare përmes pyetjeve: Si ju duk ora letrare? - Çfarë ju pëlqeu? - Çfarë nuk ju pëlqeu? - Si do ta kishit ndryshuar?
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Lista e kontrollit për hulumtimet e bëra, organizimin e orës letrare, si dhe realizimin e orës letrare.
Detyrë shtëpie
Nuk ka nevojë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mediet		**Rezultati i të nxënit të temës:** Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe me imazhe interesante.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.5; III.1,2,4,6,9; IV.3; VI.3			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 4.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Si të përgatitim një fletëpalosje			
Fjalët kyçe: fletëpalosje/fletushka, njoftim, informacione.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - analizon shembujt e fletëpalosjeve në grup; - krijon fletëpalosje në bashkëpunim me grupin; - argumenton punën e bërë për një fletëpalosje të mirëfilltë. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësve, burime nga interneti, revista, libra, fletë A4 e bardhë ose me ngjyra, lapsa me ngjyra, foto, ngjitëse, gërshërë etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Ed. Muzikore, Ed. Fizike sporti dhe shëndeti. Çështjet **ndërkurrikulare:**Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**.**			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Hapi 1

Mësuesi/ja sjell në klasë modele të ndryshme të fletë palosjeve (në mungesë të fletëpalosjeve, hulumton në internet për shembuj të tillë). U ofrohet secilit grup shembuj të fletëpalosjeve dhe hapet diskutimi:

- Shiko dhe analizo me kujdes fletëpalosjen, thuaj çfarë kupton.
- Si mendoni për çfarë shërben një fletëpalosje?
- Pse mendoni ashtu?

Hapi 2

Hapen librat dhe njoftohen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Nxënësit në grup dhe në bashkëpunim me mësuesin/en analizojnë informacionet dhe materialet e nevojshme për krijimin e fletëpalosjeve. Gjithashtu, nxënësit, në grupe, vendosin për temën që do të zgjedhin për krijimin e një fletëpalosjeje. Mësuesi/ja orienton nxënësit për temat që mund të marrin, duke u bazuar në temat që kemi trajtuar paraprakisht (gjë që ndihmon në freskimin e njohurive të marra gjatë vitit shkollor). Orientohet nxënësit në atë që duhet të përmbajë fletëpalosja. Pra, ajo shërben për të dhënë një informacion shpjegues për një temë të caktuar. Në fletëpalosje, nëpërmjet tekstit dhe vizatimit/fotove, duhet të ofrojnë informacion të shkurtër për një temë të caktuar. Duhet të jetë mesazh për të tjerët që të mbështetin idetë e tyre. Duhet të jetë i qartë dhe të kuptohet menjëherë për atë që e lexon. Paraqitet modeli i fletëpalosjes para nxënësve dhe mësuesi/ja demonstron formimin e saj. Të gjitha këto sqarime, i jep mësuesi/ja para se nxënësit të fillojnë punën praktike në klasë.



Hapi 3

Secili grup përcaktohet për temën, bën një skicë sipas idesë që kanë nxënësit.

Materialet që do përdorin janë letër e bardhe ose me ngjyra, lapsa me ngjyra, foto, ngjitëse, gërshërë etj.

Grupi 1. Si ndikon hedhja e mbeturinave në ujë?

Grupi 2. Mbrojtja e natyrës (gjelbërimit).

Grupi 3. Llojet e profesioneve

Grupi 4. Llojet e medieve

Grupi 5. Parandalimi i rreziqeve në rrugë

Nxënësit ndajnë përgjegjësit gjatë punës në grup, ku fillimisht dy anëtarë të grupeve duhet të hulumtojnë në librat/revistat (të sjella orë më parë si detyrë shtëpie) te këndi i librave dhe të gjejnë informacione shtesë rreth temës që do punojnë. Nxënësit tjerë anëtarë të grupit sipas përgjegjësive që kanë marrë vazhdojnë punën (vizatojnë skicën në fletore punës f. 35-37, krijojnë fletëpalosjen, marrin shënime, presin me gërshërë fotot etj.).

Hapi 4
Fletëpalosjet ekspozohen në turin e galerisë, nxënësit lirshëm lëvizin në klasë duke diskutuar, sqaruar, marrin formacione për temat që janë trajtuar.

Diskuto: cila është rëndësia e fletëpalosjes? Sa ndikon ajo në njohjen e informacioneve të ndryshme? Ku ke parë fletëpalosje? Përse të kanë shërbyer?

Opsionale
(Ide për fletëpalosje me temën riciklimi i materialeve 'mbrojtja e mjedisit' https://www.youtube.com/watch?v=f6-BXv8Ryoc)

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes në pjesën e parë të orës.
Vlerësohet puna praktike dhe bashkëpunimi.
Vlerësohet produkti (fletëpalosja).

DETYRË SHTËPIE

Krijo gjatë javës një fletëpalosje për të ushqyerit e shëndetshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna	**Lënda:** Shkathtësi për jetë	**Shkalla e kurrikulës**: 2	**Klasa:** III
Tema: Mediet		**Rezultati i të nxënit të temës:** Prezanton përmes TIK-ut aktivitetet e grupit të tij për një periudhë të caktuar kohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.5; III.1,2,4,6,9; IV.3; VI.3; I.3,8; III.1,2,4,6,9; VI.2,4,6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 4.1,2			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Projekt: Si të përgatit një lajm			
Fjalët kyçe: lajm, intervistë, informacion, internet, media.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nx**ënësi/ja: - analizon hapat që duhet marrë për të realizuar një lajm; - hulumton në internet për tu informuar për temën; - prezanton përmes TIK-ut lajmin e punuar në bashkëpunim. **Kriteret e suksesit:** I përcakton mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësve, kompjuter/lop-top, burime nga interneti, fotografi, ilustrime, video gjatë prezantimit të projektit etj.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Art figurativ, Ed. Muzikore, Ed. Fizike sporti dhe shëndeti. Çështjet **ndërkurrikulare:** Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi 1 Ora mësimore mbahet në kabinetin e Informatikës TIK-ut (Opsionale, në mungesë të kabinetit ora mësimore mbahet në klasë, mësuesja/i sigurohet të ketë pranë kompjuter/loaptop). Mësuesi/ja shtron pyetjen: - Si informohemi ne për ngjarjet që ndodhin? (nga media të ndryshme: radios, shtypit, transmetimit televiziv, komunikimit elektronik). - Kush bënë informimin e popullatës me të rejat që kanë ndodhur? (moderatorët, intervistuesit, gazetarët etj.). Hapi 2 Hapen librat dhe njoftohen nxënësit me temën dhe rezultatet e të nxënit të orës mësimore. Nxënësit në grup dhe në bashkëpunim me mësuesin/en analizojnë si duhet vepruar për të realizuar një lajmë. Njoftohen nxënësit që do të veprojnë në të njëjtën mënyrë sipas udhëzimeve që ofrohen në libër për të siguruar një lajmë. Fillimisht, nxënësit marrin udhëzimet për veprimet e mëtutjeshme. • Veprimi i parë: merrni informacion nga interneti, për temën "Kampi veror". Vendoset në sfond projektor faqen e internetit, si më poshtë, për të hulumtuar për informacione (nëse ora mësimore mbahet në kabinet të TIK-ut, nxënësit qëndrojnë pranë kompjuterit dhe marrin udhëzimet).			

Kopjohet materiali i zgjedhur për informacion dhe vendoset në programin *Word*.



- Veprimi i dytë: intervistoni mësuesit përgjegjës për ecurinë e kampit (Improvizim), këtu duhet të përfshihen data, vendi dhe aktivitetet.

- Veprimi i tretë: pyesni se çfarë mendojnë nxënësit që kanë vendosur të shkojnë në kamp, përmbylleni me mendimin e një prindi (improvizim), duke treguar rëndësinë e këtij kampi.

Hapi 3
Pasi nxënësit morën informacionet nga interneti dhe u informuan për hapat e mëtutjeshëm, udhëzohen që të gjithë materialin e mbledhur, ta shkruajnë me disa fjalë në programin *Word* (nxënësit që kanë vështirësi në përdorimin e kompjuterit/nuk kanë kompjuter mund ta paraqesin punën e tyre në *flip-chart*).

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Buletini i pjesëmarrjes gjatë realizimit të projekti.
Bashkëpunimi në grup dhe prezantimi i projektit.

DETYRË SHTËPIE

Nuk është e nevojshme.

Test 1

Emri/Mbiemri: _____ **Data:** _____

1. Prej çfarë materiali prodhohet libri/fletorja? 5 pikë

_____

2. Trego dy sende që janë prodhuar prej letrës dhe dy që janë prodhuar prej kartonit. 5 pikë

Prej letre	Prej kartoni

3. Trego si prodhohet letra/kartoni. 10 pikë

_____

_____

_____

4. Fibra është: _____ 8 pikë

5. Plotëso tekstin me fjalët që mungojnë: 8 pikë

Leshi përfitohet nga kafshët, si _____ dhe dhitë. Është _____ e ngrohtë, thith _____, pa e kthyer atë në trupin tonë. Përdoret për veshje _____ si triko, shall, pallto, doreza, kapuç. Leshi përdoret edhe për punimin e _____.

6. Pse fibra tekstile e pambukut nuk thuret me dorë? 9 pikë

_____

7. Plotëso diagramin e mëposhtëm: Cilat janë llojet e rreziqeve? 10 pikë



8. Trego masat mbrojtëse ndaj njërit prej rreziqeve që ke cekur më lartë. 10 pikë

_____

_____

9. Këshillat e xhaxhi zjarrfikësit ishin: 15 pikë

10. Rrëfe me 2-3 fjali një ngjarje rreziku që ke përjetuar, parë apo dëgjuar. 20 pikë

_____

_____

_____

Tabela e vlerësimit

0 – 39 (1)	40 – 59 (2)	60 – 79 (3)	80 – 89 (4)	90 – 100 (5)	Nota

Test 2

Emri/Mbiemri: _____ **Data:** _____

1. Sqaro me pak fjalë profesionet e mëposhtme: 5 pikë

Marangoz: _____

Okulist: _____

Hidraulik: _____

2. Shiko fotografitë më poshtë dhe plotëso tabelën. 5 pikë

a)

b)

Fotografia	Vendi i punës	Profesioni
a		
b		

3. Cili profesion të pëlqen? Pse? 15 pikë

_____

_____

_____

4. Përfytyro dhe përshkruaj cila do të ishte karriera jote në të ardhmen. 20 pikë



5. Çfarë materialesh janë përdorur për të ndërtuar punimin në fotografi? Pse? 15 pikë

6. Sqaro më poshtë fjalët: *Shpenzim, kosto*, *kursim*. 10 pikë

_____

_____

_____

7. Si kontribuon ti në ekonominë e shtëpisë sate? Shkruaj një shembull. 10 pikë

_____

8. Si mendon, a është kursimi kulturë? Arsyeto. 20 pikë

Po, pse?	Jo, pse?

Tabela e vlerësimit

0 – 39 (1)	40 – 59 (2)	60 – 79 (3)	80 – 89 (4)	90 – 100 (5)	Nota

Test 3

Emri/Mbiemri: _____ **Data:** _____

1. Cilat janë llojet e ndotjes së mjedisit? 5 pikë

_____

2. Çfarë kupton me fjalët: 10 pikë

Riciklo	
Redukto	
Ripërdor	

3. Sqaro procesin e riciklimit, duke u bazuar në figurë. 12 pikë

_____

_____

_____

4. Cilët janë faktorët që ndotin mjedisin ku jetoni? Çfarë pasojash sjellin ata? 10 pikë

_____

_____

5. Si kontribuon ti në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit? Shkruaj një shembull. 20 pikë

6. Cilat janë llojet e mediave? 8 pikë

_____

7. Krijo një tekst të shkurtër (tregim), duke përdorur këto fjalë kyçe:
emision televiziv, informim, aktivitet, program kompjuterik, gazetë. 15 pikë

_____
_____
_____
_____
_____
_____

8. Në tabelën e mëposhtme, klasifiko sipas llojit fjalët kyçe që ke përdorur në ushtrimin 7: 20 pikë

Media e shkruar	Media vizive

Tabela e vlerësimit

0 – 39 (1)	40 – 59 (2)	60 – 79 (3)	80 – 89 (4)	90 – 100 (5)	Nota

Referenca

- Korniza kurrikulare e Kosovës.
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor Shkathtësi për jetë, 2019
- Vlerësimi formativ (MASHT/ USAID)
- Udhëzues të ndryshëm për mësimdhënës të klasave fillore.
- Standardet për tekstet shkollore, MASHT, Kosovë.

BURIME NGA INTERNETI:

- https://www.google.al/
- https://www.dreamstime.com
- https://www.pinterest.com/

Katalogimi në botim (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:37(072)(075.2)

Libër për mësuesin : shkathtësi për jetë 3 / Laura Lipoveci Pruthi, Ilir Kuka. - Prishtinë : Botime Pegi, 2021. - 101 f. : ilustr. ; 24 cm

1. Kuka, Ilir

ISBN 978-9951-786-25-6